

Maj 2007

Siguria njerëzore në Kosovë
Studim i perceptimeve



VENDI SIGURTË
BEZBEDNOMESTO
SAFEPLACE





Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) është një organizatë joqeveritare kosovare që promovon përfshirjen e qytetarëve të Kosovës në proceset shoqërore dhe ato të vendim-marrjes përmes programeve të ideuara që përqëndrojnë vëmendjen në vlerat dhe funksionimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike.



Saferworld është një organizatë e pavarur joqeveritare që punon me qeveritë dhe shoqëritë civile në planin ndërkombëtar për të hulumtuar, promovuar dhe zbatuar strategji të reja për të rritur sigurinë e njerëzve dhe për të parandaluar dhunën e armatosur.

Siguria njerëzore në Kosovë

Studim i përceptimeve

Falënderimet

Ky raport u shkrua nga ekipi i projektit VendiSigurtë i Forumit të Iniciativës Qytetare dhe Saferworld. Dëshirojmë të falënderojmë Qeveritë e Mbretërisë së Bashkuar dhe Gjermanisë për financimin e këtij studimi nëpërmes përkrahjes së tyre për projektin VendiSigurtë. Gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë edhe Steve Walker për përkrahje në dizajnin grafik.

Përmbledhje

Ky dokument hulumton perceptimet e sigurisë, sigurisë në komunitet dhe përhapjen e armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë bazuar në shënimet e mbledhura në dhjetor të vitit 2006 në një hulumtim shtëpiak në mbarë Kosovën me 1,153 të intervistuar dhe disa diskutime të fokus grupeve. Raporti analizon rolin e faktorëve të ndryshëm përfshirë të ardhurat, moshën, etninë, gjininë dhe vendin, të cilët ndikojnë në perceptimet e sigurisë dhe sigurisë në komunitet. Ky studim është krijuar për t'u përsëritur rregullisht në mënyrë që të vërehen perceptimet që ndryshojnë mbi këto çështje në Kosovë. Studimi aktual, që edhe është i pari, është fokusuar në katër fusha kryesore: sigurinë në komunitet; perceptimet mbi konfliktin; perceptimet mbi garantuesit e sigurisë; dhe posedimin dhe përdorimin e armëve.

Rezultatet e studimit tregojnë shkallën në të cilën perceptimet mbi sigurinë aktualisht ndryshojnë nëpër grupe etnike të ndryshme, ku shumica e të intervistuarve Shqiptarë të Kosovës ndihen më të sigurt në krahasim me të intervistuarit Serbë të Kosovës. Sidoqoftë, faktorët socio-ekonomik si papunësia dhe varfëria gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm. Për shembull, studimi zbuloi që faktorët socio-ekonomik janë më të rëndësishëm në nxitjen e emigrimit nga Kosova dhe në ndjenjën e pasigurisë. Perceptimet mbi sigurinë në komunitet lidhen me perceptimet mbi nivelet e krimit. Pasuria dhe vendi ishin faktorë të rëndësishëm në përcaktimin e shkallës së frikës nga krimi. Të intervistuarit më të pasur ishin më të frikësuar që ata ose anëtarët e familjes së tyre mund të bëhen viktimë e krimit, derisa disa komuna treguan nivele shumë më të ulëta të krimit se komunat tjera. Serbët e Kosovës raportuan një nivel më të lartë dhe të shpeshtë të krimit në krahasim me të intervistuarit nga grupet tjera etnike, një fakt i cili ka gjasa të ndërlidhet me perceptimet e tyre të fuqishme mbi pasigurinë.

Shumica e njerëzve të intervistuar besonin se statusi i pazgjidhur i Kosovës mund të nxijë një konflikt tjetër; sidoqoftë, ky mendim ndryshonte nëpër shoqëri. Të rinjtë duket të jenë më pozitiv se të moshuarit mbi zgjidhjen e konfliktit nëpërmes mënyrave paqësore, dhe gjithashtu përmendin papunësinë si nxitësin kyç të konfliktit të mundshëm. Një shumicë e të intervistuarve besonin se konfliktet në nivelin komunal mund të zgjidheshin në mënyrë paqësore, dhe derisa këto nivele të besimit nuk reflektoheshin në komunat me shumicë Serbe të Kosovës Veriore, një shumicë e madhe e të intervistuarve në Kamenicë, një komunë me etni të përzier ku edhe ka shumë Serbë të Kosovës, ndjeheshin të sigurt që konfliktet në nivelin komunal mund të zgjidheshin në mënyrë paqësore.

Një nga problemet primare që dëmton zgjidhjen paqësore të konfliktit dhe progresin në reformën e sektorit të sigurisë kryesisht është niveli i ulët i besimit të njerëzve të Kosovës tek garantuesit e sigurisë. Nivelet e besimit në Policinë e UNMIK-ut janë shumë të ulëta, dhe edhe pse KFOR-i besohet nga shumë, përsëri niveli i besimit mbetet i ulët. Besimi në gjyqësi gjithashtu është i ulët. Studimi zbuloi se Shërbimi Policor i Kosovës (ShPK) ishte me i besueshmi nga të gjithë garantuesit e sigurisë, përkundër besimit të një numri të madh të intervistuarve se është nën ndikimin politik. Moshë, etnia dhe gjinia e të intervistuarve luajnë rol në ndikimin e qëndrimeve ndaj ShPK-së. Për shembull, femrat kanë më shumë besim në ShPK-në se meshkujt, dhe të rinjtë kanë më shumë besim në këtë institucion (dhe Trupat Mbrotjtëse të Kosovës) se të moshuarit.

Studimi gjithashtu vështroi edhe posedimin dhe përdorimin e armëve dhe faktorët të cilët mund të nxitin njerëzit që të dorëzojnë armët. Shumica e të intervistuarve besojnë se

posedimi i armëve të zjarrit nuk i bënë ose nuk do t'i bënte ata ose familjet e tyre më të sigurt, dhe se posedimi ilegal i armëve të zjarrit paraqet kërcënim për prosperitetin e Kosovës. Gjithashtu kishte edhe një nivel të konsensusit se pse njerëzit vazhdojnë të posedojnë armë, dhe çfarë do t'i nxiste ata që të dorëzonin armët e tyre vullnetarisht.

Sipas rezultateve të hulumtimit, shumica e njerëzve konsiderojnë frikën nga konflikti apo jostabiliteti i ardhshëm si arsye kryesore pse njerëzit nuk i dorëzojnë armët e tyre gjatë amnestive të armëve, ndërsa edhe tradita luanë një rol.

Përmbajtja

Hyrje.....	9
Siguria në komunitet.....	11
Kërcënimet ndaj sigurisë.....	14
Ndryshimet në perceptimet mbi sigurinë	21
Perceptimet mbi konfliktin	23
Shkaqet e konfliktit.....	24
Perceptimet mbi garantuesit e sigurisë	27
Shërbimi Policor i Kosovës.....	29
Trupat Mbrojtëse të Kosovës	31
Gjyqësia.....	32
Garantuesit ndërkombëtar të sigurisë	33
Mekanizmat lokal dhe ndërkombëtar të sigurisë	34
Qëndrimet ndaj shërbimeve inteligjente	35
Posedimi dhe përdorimi i armëve	37
Iniciativat për mbledhjen e armëve	39
Përfundim.....	41
Aneksi A: Margjina e gabimit	42

Lista e figurave

Figura 1: Kategoritë e moshës së të intervistuarve.....	9
Figura 2: A do të përshkruani lagjen tuaj si ...?.....	11
Figura 3: Perceptimet mbi sigurinë në Kosovë sipas komunave.....	12
Figura 4: A planifikoni të emigroni nga Kosova në pesë vitet e ardhshme?	14
Figura 5: Sa të frikësuar jeni që ju ose familja juaj mund të bëheni viktimë të krimit?	15
Figura 6: Frika nga krimi në Kosovë	16
Figura 7: Lidhja në mes frikës nga krimi dhe pasurisë.....	18
Figura 8: Sipas mendimit tuaj, cilat lloje të krimeve ndodhin më shpesh në komunitetin tuaj?.....	19
Figura 9: Ndikimi i gjinisë në perceptimet mbi krimin e ndodhur më shpesh.....	20
Figura 10: Në vitin 2007, UNMIK-u pritet të zëvendësohet nga prania e re e BE-së. Si mendoni se do të ndikohet siguria juaj nga kjo prani e re ndërkombëtare?.....	22
Figura 11: Sipas mendimit tuaj, sa ka gjasa që Kosova të ketë një konflikt tjetër të dhunshëm në pesë vitet e ardhshme?	23
Figura 12: Sipas mendimit tuaj, sa ka gjasa që Kosova të ketë një konflikt tjetër të dhunshëm në pesë vitet e ardhshme?	24
Figura 13: Cilët faktorë mendoni se kanë më shumë potencial të shkaktojnë konflikt në të ardhmen?	25
Figura 14: Ata që i janë përgjigjur 'plotësisht' pyetjes 'Sa besim keni tek ShPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut dhe TMK-ja?'	28
Figura 15: Sa besim keni tek ShPK-ja?.....	30
Figura 16: Komunitat në të cilat besimi në ShPK-në është më i larti dhe me i ulëti.....	30
Figura 17: Sa besim keni tek KFOR-i?	33
Figura 18: Sipas mendimit tuaj, cilat nga veprimet në vazhdim do të nxitnin më së miri njerëzit në komunitetin tuaj që të dorëzonin armët e tyre ilegale?	40

Akronimet dhe shkurtesat

AVL	Armët e vogla dhe të lehta
BE	Bashkimi Evropian
FGD	Fokus grup diskutime
FIQ	Forumi i Iniciativës Qytetare
HSh	Hulumtimi shtëpiak
IHSOP	Instituti për Hulumtime Strategjike të Opinionit Publik
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse
KFOR	Forcat e Kosovës (NATO)
KKSK	Këshilli Komunal i Sigurisë në Komunitet
KLSP	Komisioni Lokal i Sigurisë Publike
KMDNMK	Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve në Kosovë
NATO	Organizata e Traktit Veri Atlantik
OJQ	Organizatë joqeveritare
PZhBV	Personat e zhvendosur brenda vendit
RSSB	Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme
SHIK	Shërbimi Informativ i Kosovës
ShPK	Shërbimi Policor i Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Administrimit i Kombeve të Bashkuara

Hyrje

Ky studim u ndërmor nga Forumi i Iniciativës Qytetare dhe Saferworld nga dhjetori 2006 deri në shkurt 2007, në mënyrë që të vlerësohen në mënyrë të pavarur dhe të qartë perceptimet publike mbi sigurinë, sigurinë në komunitet dhe armët e vogla dhe të lehta (AVL) si dhe qëndrimet ndaj tyre në Kosovë.

Në mënyrë që të sigurohet një nivel i lartë i saktësisë dhe mundësisë për një analizë të detajizuar të situatës, u përdorën disa metoda hulumtuese përfshirë edhe:

- Një hulumtim shtëpiak (HSh) në mbarë Kosovën i drejtuar nga Forumi i Iniciativës Qytetare dhe Komiteti për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve në Kosovë (KMDNMK), në Gjuhë Shqipe dhe Serbe varësisht prej përshtatshmërisë.
- Gjashtë fokus grup diskutime (FGD) (me të intervistuar meshkuj dhe femra); një në Prishtinë, dy në Mitrovicë, një në Gjilan, një në Obiliq dhe një në Prizren. FGD-të janë përdorur për të vërtetuar rezultatet e HSh-së dhe për të fituar një kuptim më të thellë të perceptimeve të qytetarëve mbi situatën e sigurisë në Kosovë.
- Gjetjet nga fokus grup diskutimet shtesë të ndërmarra gjatë shkurtit dhe marsit 2007 janë përdorur për të plotësuar gjetjet nga FGD-të dhe HSh-ja origjinale.

HSh-ja u krye në mbarë Kosovën dhe një shembull përfaqësues i 1,153 të intervistuarve u përzgjedh për mbledhjen e shënimeve. Diferenca standarde e gabimit për këtë madhësi të shembullit dhe popullsisë është 2.89 përqind në një nivel besueshmërie prej 95 përqind (shih Aneksin A për më shumë detaje). Drejtuar në dhjetor të vitit 2006, shënimet e këtij studimi janë mbledhur parimisht nga intervistat me kryefamiljarët, dhe kur ishte e përshtatshme edhe me femra (pavarësisht nga pozita e tyre në shtëpi). Për shkak se një shumicë e kryefamiljarëve të shtëpive në Kosovë janë meshkuj, në mënyrë që të ofrohet një bilanc adekuat i gjinive, femrat janë intervistuar në çdo të dytën apo katërtën shtëpi. Në përgjithësi, 56.1 përqind e të intervistuarve ishin meshkuj dhe 43.9 përqind ishin femra. Mbi tre çerek ishin mbi moshën 35 vjeçare. Struktura e moshës është treguar në figurën më poshtë:




Figura 1: Kategoritë e moshës së të intervistuarve.
Numri bazë: 1,153

Prapavija edukative e të intervistuarve ndryshonte, duke filluar nga të intervistuarit pa ndonjë edukim formal, deri tek ata me shkallë universitare. Prapavija edukative më e

zakonshme ishte shkolla e mesme e kryer (38.9 përqind). 79.6 përqind e të intervistuarve ishin Shqiptarë të Kosovës, 17.5 përqind ishin Serbë të Kosovës¹, derisa 2.9 përqind i takonin një etniteti tjetër. Shtirja urbane-rurale ishte me 56.6 përqind të intervistuarve në vendet rurale dhe 43.4 përqind në vendet urbane.

Në përgjithësi, të intervistuarit Shqiptarë të Kosovës dukej se perceptonin situatën e sigurisë në mënyrë më pozitive se të intervistuarit Serbë të Kosovës. Të intervistuarit Serbë të Kosovës gjithashtu dukej të kishin nivele të ulëta të besimit në garantuesit e sigurisë, si lokal ashtu edhe ndërkombëtare, edhe pse nivelet e besimit në përgjithësi ishin të ulëta. Siç ishte rasti me hulumtimet e njëjta në të kaluarën,² pyetjet në lidhje me Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL) nxorën nivelin më të lartë të refuzimit, ku shumica e të intervistuarve zgjidhnin që mos të përgjigjeshin, ose përgjigjeshin 'nuk di' në disa pyetje të lidhura me AVL-të më shumë se në pyetjet tjera, ku tregohet se çështja e posedimit të AVL-ve vazhdon të jetë e ndjeshme për shumë njerëz në Kosovë. Proporcioni i lartë i të intervistuarve që zgjedhën të mos përgjigjeshin në pyetje të caktuara nuk duhet domosdo të merret si një tregues i faktit që të intervistuarit fshehin diçka. Sidoqoftë, kjo duhet të merret parasysh në përpjekjen për nxjerrjen e përfundimeve të përgjithshme dhe gjetjen e shembujve në lidhje me posedimin dhe përdorimin e AVL-ve në Kosovë.

¹ Edhe pse nuk ekzistojnë statistika të sakta, Serbët e Kosovës vlerësohet të përbëjnë aktualisht rreth 5 përqind të popullsisë së Kosovës. Sidoqoftë, kompanitë e hulumtimeve shtëpiake në Kosovë duket të përfshijnë një proporcion më të madh të intervistuarve me prapavijë Serbe në shembujt e tyre për t'u siguruar që opinionet publike të Serbëve të Kosovës të cilët jetojnë në Kosovë në kontekste shumë të ndryshme në mbarë Kosovën janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate.

² Shih për shembull Sokolová, J. et. al. *Hulumtimi i AVL-ve në Kosovë*, (SEESAC, 2006)

Siguria në komunitet

Shumica e të intervistuarve për këtë hulumtim perceptonin lagjen e tyre si 'shumë e sigurt' (15.6 përqind) ose 'e sigurt' (48.7 përqind). Vetëm 13.4 përqind perceptonin lagjen e tyre si 'e pasigurt' ose 'shumë e pasigurt'. Në krahasim me këto shifra të përgjithshme, vetëm 4.5 përqind e Serbëve të Kosovës konsideronin lagjen e tyre si 'shumë e sigurt' ose 'e sigurt'. Derisa një proporcion i madh (43.6 përqind) i të intervistuarve Serbë të Kosovës u përgjigjën 'as e sigurt e as e pasigurt' në këtë pyetje, gati gjysma (48 përqind) konsideronin lagjen e tyre si 'e pasigurt' ose 'shumë e pasigurt'. Kjo është shumë e ndryshme me përgjigjet e dhëna nga të intervistuarit Shqiptarë, Romë, Boshnjakë dhe Ashkali të Kosovës, 77.1 përqind e të cilëve konsideronin lagjen e tyre si 'shumë e sigurt' ose 'e sigurt', dhe vetëm 6.1 përqind ndjenin se lagja e tyre është 'e pasigurt' ose 'shumë e pasigurt'.




Figura 2: A do të përshkruani lagjen tuaj si ...?
Numri bazë: 1,153


Disa komuna u identifikuan si veçanërisht të sigurta në këtë studim. Të gjithë të intervistuarit në Dragash, Glllogoc, dhe Rahovec, dhe mbi 90 përqind të intervistuarve në pesë komuna tjera³ deklaruan për lagjet e tyre si 'shumë e sigurt' ose 'e sigurt'. I vetmi vend që perceptohej si i pasigurt nga shumica e banorëve të tij ishte Zveçani, një nga katër komunat e Kosovës me shumicë Serbë të Kosovës, ku Serbët përbëjnë diku 72.6 përqind të popullsisë.⁴ 25.3 përqind e popullsisë janë Persona të Zhvendosur Brenda Vendit (PZhBV) ku shumica e tyre janë Serbë të Kosovës. Vetëm 2.1 përqind e popullsisë janë Shqiptarë të Kosovës, dhe shumica e tyre jetojnë në tri fshatra të cilat janë ta banuara vetëm nga Shqiptarët e Kosovës.⁵

³ Glllogoc, Ferizaj, Malishevë, Shtime, Istog.

⁴ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Profili Komunal: Zveçan* (Qershor 2006). Mund të gjendet në adresën: http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/1209_en.pdf

⁵ Ibid

Figura 3: Perceptimet mbi sigurinë në Kosovë sipas komunave⁶
Dizajni: Steve Walker



Numri i Komunave

- | | | |
|------------------|---------------|-----------------|
| 1. Deçan | 11. Leposaviq | 21. Prizren |
| 2. Dragash | 12. Lipjan | 22. Skenderaj |
| 3. Gjakovë | 13. Malishevë | 23. Shtërpçë |
| 4. Gllgoc | 14. Mitrovicë | 24. Shtime |
| 5. Gjilan | 15. Novobërdë | 25. Suharekë |
| 6. Istog | 16. Obiliq | 26. Ferizaj |
| 7. Kaçanik | 17. Rahovec | 27. Viti |
| 8. Kamenicë | 18. Pejë | 28. Vushtrri |
| 9. Klinë | 19. Podujevë | 29. Zubin Potok |
| 10. Fushë Kosovë | 20. Prishtinë | 30. Zveçan |

⁶ Niveli i sigurisë së perceptuar është përcaktuar duke vlerësuar sigurinë prej 5 deri 1 (ku 5 është "shumë e sigurt" dhe 1 është "shumë e pasigurt") dhe duke e shumëzuar vlerën me përqindjen e të intervistuarve në komunën në të cilën janë përgjigjur. Më pastaj, niveli total i sigurisë së perceptuar është shuma e këtyre numrave ("shumë e sigurt" ka vlerën prej 43-52; "sigurt" 33-42; "as sigurt as pasigurt" 23-32 dhe "pasigurt" 13-22). Kjo mundëson krahasimin në mes komunave pasi që numri i të intervistuarve në cilëndo komunë nuk ndikon në nivelin e përgjithshëm të perceptuar të sigurisë. Kjo gjithashtu mundëson krahasimin në lidhje me nivelin e përgjithshëm të sigurisë së perceptuar e jo numrin e të intervistuarve që japin vetëm një përgjigje.

Çuditërisht, një proporcion i madh i femrave (19.2 përqind) më shumë se meshkujt (12.8 përqind) perceptuan lagjen e tyre si 'shumë e sigurt.'

Kur u pyetën nëse nivelet e sigurisë në lagjen e tyre kishin ndryshuar gjatë gjashtë muajve të fundit, shumica e të intervistuarve (71.7 përqind) deklaruan se nivelet kanë mbetur të njëjta. 13.7 përqind ndjenin se siguria ishte rritur, derisa 8.8 përqind mendonin se nivelet e sigurisë kanë ndryshuar. Të gjitha përveç njëjës komunë u pajtuan me mendimin e përgjithshëm se nivelet e sigurisë kanë mbetur të pandryshuara gjatë 6 muajve të fundit. Vetëm në Dragash shumica e të intervistuarve (86.7 përqind) deklaruan se mendonin që nivelet e sigurisë në komunitetin e tyre janë përmirësuar. Kjo mund të vijë si rezultat i rritjes së patrullimeve të policisë në Dragash pas paraqitjes së Njësitit Policor të Kalorësisë të Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK).⁷ Sidoqoftë, nevojiten më shumë hulumtime për të ekzaminuar ndonjë lidhje të mundshme në mes tyre.

Hulumtimi për këtë studim tregon se mbi dy të tretat e njerëzve planifikojnë të qëndrojnë në Kosovë në pesë vitet e ardhshme, derisa vetëm 13.8 përqind e të intervistuarve deklaruan se planifikojnë të emigrojnë brenda kësaj periudhe, dhe 17 përqind janë të pavendosur. Nuk ka ndonjë mospërputhje të madhe në mes numrit të Shqiptarëve të Kosovës dhe Serbëve të Kosovës të cilët dëshirojnë të mbesin në Kosovë. Edhe pse Serbët e Kosovës shpesh të portretizuar si ata të cilët planifikojnë të largohen nga Kosova për shkak të shqetësimeve mbi sigurinë e tyre, vetëm 6.9 përqind e përmendën këtë si arsye gjatë hulumtimit. Në fakt, papunësia dhe shqetësimet tjera socio-ekonomike perceptohen si faktorë të rëndësishëm të cilët kontribuojnë në pasiguri dhe dëshirën e njerëzve për të emigruar nga Kosova.

Derisa 55.9 përqind e Serbëve të Kosovës deklaruan se nuk kanë pasur për qëllim që të emigrojnë nga Kosova gjatë pesë viteve të ardhshme (krahasuar me 70.2 përqind të Shqiptarëve dhe minoriteteve jo-Serbe), 32.7 përqind nuk ishin të vendosur. Kjo pavendosmëri mund të vijë si rezultat i pasigurisë së mbetur në lidhje me statusin e ardhshëm të Kosovës. Ky studim është krijuar që të përsëritet rregullisht në mënyrë që të vërehen perceptimet mbi sigurinë të cilat ndryshojnë dhe kështu hulumtimi në vazhdim do të ketë për qëllim të zbuloj më shumë mbi qëllimet e Serbëve të Kosovës në këtë aspekt.

Nuk duket të ketë ndonjë lidhje reciproke në mes atyre që konsiderojnë emigrimin nga Kosova dhe perceptimet e sigurisë në komunitet. Për shembull, 51.6 përqind e atyre të cilët deklaruan që planifikojnë të emigrojnë nga Kosova brenda pesë viteve të ardhshme gjithashtu konsideruan se komuniteti i tyre ishte 'i sigurt', ku 11.9 përqind deklaruan se ishte 'shumë i sigurt'. Nga ata të cilët deklaruan se dëshirojnë të emigrojnë, vetëm 18.3 përqind perceptonin lagjen e tyre si 'të pasigurt' ose 'shumë të pasigurt'.

Edhe pse nevojitet hulumtim i mëtejshëm për të vërtetuar këto shënime, tregohet se dëshira për t'u larguar nga Kosova nuk është domosdo rezultat i shqetësimeve mbi sigurinë, por më shumë si rezultat i faktorëve tjerë. Hulumtimi tregon se mosha dhe niveli i gjendjes ekonomike mund të jenë faktor të cilët ndikojnë në dëshirën e njerëzve për t'u larguar nga Kosova. Përvoja e vështirësive ekonomike u mat nga përgjigjet në pyetjen se çfarë proporcioni të të ardhurave mujore e shpenzojnë të intervistuarit për ushqim. Përqindja më e lartë (19 përqind) e të intervistuarve që planifikonin të emigronin nga Kosova i takonin kategorisë e cila tregoi nivelet më të larta të vështirësive ekonomike, domethënë

⁷ Zëdhënësi i ShPK-së, intervistë telefonike, 17 maj 2007.

ata të cilët zgjedhën mundësinë 'të ardhurat e familjes tonë nuk mjaftojnë, familja ynë nga jashtë na ndihmojnë' kur u pyetën mbi proporcionin e të ardhurave të tyre mujore që shpenzojnë për ushqim.⁸ Për dallim, përqindja më e ulët e atyre që dëshironin të largoheshin nga Kosova (9.1 përqind) bie në kategorinë e cila tregonte nivelin më të madh të pasurisë, kur proporcioni i të ardhurave mujore të shpenzuara për ushqim ishte 'një çerek'.

Hulumtimi gjithashtu tregoi se të rinjtë ka më shumë mundësi të planifikojnë emigrimin nga Kosova gjatë pesë viteve të ardhshme se të moshuarit. Siç shihet në Figurën 4 më poshtë, një proporcion i madh i kategorisë së moshës prej 18-24 planifikojnë të emigrojnë nga Kosova brenda pesë viteve të ardhshme më shumë se ata që bien në kategorinë e moshës prej 55 e më lartë.




Figura 4: A planifikoni të emigroni nga Kosova në pesë vitet e ardhshme?
Numri bazë: 1,153

Për këtë arsye është e mundshme që vështirësitë ekonomike dhe të rinjtë janë nxitësit e dëshirës për të emigruar nga Kosova. Kjo mbështetet nga llogaritja se 63 përqind e atyre në moshën prej 15 deri 24 vjeç janë të papunësuar.⁹

Kërcënimet ndaj sigurisë

Krimi

Kur u pyetën nëse ishin të frikësuar se ata ose ndonjë anëtarë i familjes së tyre mund të bëhej viktimë e krimit, përgjigjet e njerëzve ndryshonin. 34.1 përqind deklaruan se nuk

⁸ Kjo përgjigje nuk tregon vetëm nivelin e vështirësive ekonomike por edhe që të intervistuarit mund të kenë një rrjet familjar jashtë, i cili mund të lehtësoj procesin e largimit në një shtet tjetër. Në këto raste, anëtarët e familjes që janë jashtë mund të jenë faktor në marrjen e vendimeve nga njerëzit po aq sa edhe varfëria.

⁹ Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë (UNDP, 2006)

ishin 'aspak të frikësuar', ku proporcioni i mbetur dhanë përgjigje të cilat ndryshonin nëpër nivele të frikës. Shumica e 15.9 përqind të atyre që deklaruan se ishin 'shumë të frikësuar' ishin Serbë të Kosovës. 69.8 përqind e Serbëve të Kosovës ishin 'shumë të frikësuar' që ata ose anëtarët e familjes së tyre mund të bëheshin viktimë e krimit, dhe 26.7 përqind ishin 'të frikësuar'. Për dallim, shumica e të intervistuarve të Shqiptarëve të Kosovës deklaruan se ndjeheshin 'jo shumë të frikësuar', ose 'të pafrikësuar'.





Figura 5: Sa të frikësuar jeni që ju ose familja juaj mund të bëheni viktimë të krimit?
Numri bazë: 1,153

Frika e të intervistuarve nga krimi ndryshonte shumë varësisht prej vendit në të cilin jetojnë. Në disa komuna, proporcione të rëndësishme të intervistuarve frikësoheshin se mund të bëheshin viktimë e krimit. Kjo vërehet më shumë në Leposaviq, Zubin Potok, Shtërpçë dhe Zveçan, ku të gjithë të intervistuarit ishin ose 'shumë të frikësuar' ose 'të frikësuar' se mund të bëheshin viktimë e krimit. Komunitatet ku proporcione më të mëdha të intervistuarve deklaruan se ishin 'jo shumë të frikësuar' ose 'të pafrikësuar' ishin Rahoveci (të gjithë të intervistuarit), Malisheva (85 përqind), Klina (84 përqind), dhe Skenderaj (83.3 përqind).

Leposaviqi është i dallueshëm për numrin më të madh të intervistuarve të cilët frikësoheshin se mund të bëheshin viktimë e krimit.

Figura 6: Frika nga krimi në Kosovë¹⁰
Dizajni: Steve Walker



Është shumë interesante të krahasohen nivelet e raportimit të frikës nga krimi me perceptimet e sigurisë në komunitet. Për shembull, nga katër komunat ku të gjithë të intervistuarit deklaruan se frikësoheshin se mund të bëheshin viktimë e krimit, vetëm në Zveçan një proporcion i rëndësishëm i të intervistuarve (87 përqind) gjithashtu vlerësojnë lagjen e tyre si 'e pasigurt' ose 'shumë e pasigurt'. Për dallim, në Leposaviq, Zubin Potok dhe Shtërpçë, mendimet në lidhje me këtë çështje, edhe pse negative, ishin më pak

¹⁰ Niveli i frikës nga krimi është përcaktuar nga vlerësimi i frikës nga krimi prej 5 deri 1 (ku 5 është "shumë të frikësuar" dhe 1 "aspak të frikësuar") dhe shumëzimi me vlerën e përqindjes së të intervistuarve në komunë ku janë përgjigjur. Totali i nivelit të frikës nga krimi në një komunë pastaj është shuma e këtyre vlerave ("shumë të frikësuar" me vlerën prej 41-50; "të frikësuar" 31-40, "as të frikësuar as të pafrikësuar" 21-30, dhe "aspak të frikësuar" 13-22). Kjo mundëson krahasimin në mes komunave pasi që numri i të intervistuarve në cilëndo komunë nuk ka efekt në nivelin e përgjithshëm të sigurisë së perceptuar. Kjo gjithashtu mundëson krahasimin në lidhje me nivelin e përgjithshëm të sigurisë së perceptuar e jo numrin e të intervistuarve që japin vetëm një përgjigje.

ekstreme, ku përgjigjet ishin më të ndara barabar në mes perceptimeve mbi lagjen e tyre si 'as e sigurt as e pasigurt', dhe perceptimeve se lagja e tyre është veçanërisht e pasigurt. Për më shumë, kur kjo krahasohet me Figurën 3 më lartë, mund të shihet se Glllogoci dhe Rahoveci, dy nga tri komunat që janë vlerësuar si 'të sigurta' ose 'shumë të sigurta' nga të gjithë të intervistuarit që jetojnë atje, ishin ndër ato komuna ku shumica e të intervistuarve nuk ishin të frikësuar se mund të bëheshin viktimë e krimit.

Sidoqoftë, derisa 66.7 përqind e të intervistuarve në Dragash deklaruan se ishin 'jo shumë të frikësuar' ose 'aspak të frikësuar' nga krimi, një total prej 26.7 përqind të intervistuarve raportuan se ishin 'të frikësuar' ose 'shumë të frikësuar'. Kjo është interesante duke marrë parasysh se të gjithë të intervistuarit në komunë konsideruan se lagja e tyre ishte 'e sigurt' ose 'shumë e sigurt'. Kjo mospërputhje mund të shpjegohet nga fakti se pyetja në lidhje me frikën nga krimi nuk ka specifikuar vendin e krimit, dhe si rrjedhojë mund të ndodh që edhe pse të gjithë të intervistuarit ndjeheshin të sigurt në lagjen e tyre, një proporcion i tyre frikësohen se ata ose ndonjë anëtarë i familjes së tyre mund të bëhen viktimë e krimit jashtë lagjes së tyre.

Dy kontekste të ndryshme në Kosovë: Fokusi në Zveçan dhe Glllogoc

Për të ilustruar dallimet në mes komunave, është e dobishme të krahasohet komuna e vogël e Zveçanit në Kosovën Veriore, e cila kryesisht banohet nga Serbë të Kosovës dhe shumë pak Shqiptarë të Kosovës, me Glllogocin, një komunë relativisht e madhe e cila kryesisht banohet me Shqiptarë të Kosovës në Kosovën qendrore. Zveçani ka një papunësi të madhe (sidomos pas mbylljes së Trepçës në vitin 2000), dhe zhvillim të dobët ekonomik me investime kapitale të pakta. Ekonomia e Glllogocit është kryesisht agrare, ku shumica e popullatës janë të punësuar në biznese familjare dhe jo produktive.

Të gjithë të intervistuarit nga Zveçani ishin "shumë të frikësuar" ose "të frikësuar" se mund të bëheshin viktimë e krimit, dhe 87 përqind ndjeheshin se lagjet e tyre ishin ose "shumë të pasigurta" ose "të pasigurta". Për dallim prej kësaj, 64 përqind e të intervistuarve në Glllogoc ishin "të pafrikësuar" ose "jo shumë të frikësuar" nga krimi.

Këto dy komuna kanë përafërsisht numër të njëjtë të policëve të ShPK-së të pranishëm për kokë. Kur u pyetën se kë do të thërrisnin në rast do të kërcënoheshin me dhunë, një shumicë e madhe në Glllogoc dhe Zveçan zgjedhën "askënd" ose "të afërmit, shoqërinë ose fqinjët" (respektivisht 96.0 përqind dhe 82.6 përqind) si zgjedhjen e tyre të parë. Sidoqoftë, për zgjedhjen e dytë dhe të tretë, përgjigjet ndryshojnë. Në Zveçan, prej atyre të cilët raportuan një zgjedhje të dytë, 78.3 përqind do të thërrisnin KFOR-in, dhe prej atyre të cilët bënë një zgjedhje të tretë, 82.6 përqind do të thërrisnin UNMIK-un. Këtu, ShPK-ja gjendet shumë pak në zgjedhjen e dytë dhe të tretë. Por në Glllogoc, 48 përqind do të thërrisnin ShPK-në si zgjedhje të dytë.

Hulumtimi tregon disa lidhje në mes pasurisë relative dhe frikës nga krimi: njerëzit më të pasur ishin më të frikësuar se ata ose anëtarët e familjes së tyre mund të bëheshin viktimë e krimit. 43.6 përqind e të intervistuarve që i takonin kategorisë e cila tregon nivelin më të lartë të pasurisë (proporcioni i të ardhurave mujore të shpenzuara për ushqim është 'më pak se një çerek'), janë 'shumë të frikësuar'. Për dallim, vetëm 7.9 përqind e të intervistuarve që janë në kategorinë e të ardhurave e cila tregon nivelin më të madh të varfërisë ('të ardhurat e familjes tonë nuk janë të mjaftueshme, familja jonë nga jashtë na ndihmon') janë 'shumë të frikësuar'.




Figura 7: Lidhja në mes frikës nga krimi dhe pasurisë
Numri bazë: 363

Hulumtimi gjithashtu tregon se ata të cilët kanë nivel më të lartë të edukimit duket të jenë më të frikësuar se ata të cilët nuk kanë edukim që ata ose anëtarët e familjes së tyre mund të bëheshin viktimë e krimit. 22 përqind e atyre të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme janë 'shumë të frikësuar' në krahasim me 6.5 përqind të atyre të cilët nuk kanë edukim.

Ndodhia e krimit

Në total, 13.1 përqind e të intervistuarve deklaruan se ata ose ndonjë anëtar i familjes së tyre kanë qenë viktimë e krimit së paku një herë në gjashtë muajt e fundit. 6.0 përqind e të intervistuarve raportuan dy incidente të krimit, dhe 2.5 përqind thanë se ata ose familja e tyre kanë qenë viktimë e krimit tri herë gjatë asaj periudhe. Krimi më i zakonshëm i raportuar tek hulumtuesit ishte grabitja/vjedhja (9.5 përqind e të intervistuarve), ku 2.7 përqind raportuan mbi një incident me grabitje/vjedhje të armatosur dhe 2.4 përqind deklaruan se ose ata ose familja e tyre kanë qenë të kërcënuar në gjashtë muajt e fundit. Nga 243 incidente të krimit të raportuara nga të intervistuarit e HSh-së, 16.5 përqind ishin të lidhura me AVL, dhe kjo përqindje mund të jetë më e madhe nëse përfshihen edhe krimet në të cilat ka pasur të përfshira AVL, si vrasja ose sulmi. Kjo shifër gjithashtu është vërtetuar me shënimet e mbledhura nga HSh-ja e kryer për "Hulumtimi i AVL-ve në Kosovë"

në mars të vitit 2006, i cili zbuloi që 8.1 përqind e të gjitha krimeve të raportuara tek hulumtuesit ishin të lidhura me AVL.¹¹

Hulumtimi për studimin aktual zbuloi një perceptim se grabitja ose vjedhja ishin krimet më të kryera në komunitetet e të intervistuarve (sipas 36.6 përqind e të intervistuarve), ku vetëm 6.9 përqind e të intervistuarve deklaruan se mendonin që krimet e lidhura me AVL (si grabitjet/vjedhjet e armatosura, kërcënimet e armatosura dhe të shtënat) ishin kryer shpesh në komunitetin e tyre.

Serbët e Kosovës të pyetur për këtë studim raportuan ndodhi më të shpeshta të gati secilit lloj të krimit në komunitetet e tyre. Është interesante të përmendet se të intervistuarit Serbë të Kosovës perceptojnë krimet si kërcënimet, sulmet apo vjedhjet, dhe sidomos krimet e lidhura me AVL, si më të shpeshta në krahasim me grupet tjera të pranishme në Kosovë. Ashtu si përmendet më poshtë, krimi është identifikuar edhe nga Serbët e Kosovës si një nga shqetësimet kryesore të sigurisë në komunitetin e tyre (shih seksionin 'Shqetësimet e sigurisë' më poshtë). Për shkak të mungesës së shënimeve statistikore të qarta dhe të besueshme, nuk është e mundur të deklarohet përfundimisht nëse fakti që të intervistuarit Serbë të Kosovës raportojnë perceptimet më të larta të krimit është në fakt një reflektim i ndodhisë më të madhe të krimit i cili prek Serbët e Kosovës, apo është një reflektim i ndjenjës më të madhe të pasigurisë dhe pacenueshmërisë.




Figura 8: Sipas mendimit tuaj, cilat lloje të krimeve ndodhin më shpesh në komunitetin tuaj? (mundësi për më shumë përgjigje)
Numri bazë: 1,153

Më shumë të intervistuar meshkuj se femra perceptojnë 'grabitjen dhe vjedhjen' (40.2 përqind) dhe 'kërcënimin me armë' (14.0 përqind) si krimet më të shpeshta në

¹¹ Sokolová, J. et. al. op. cit., p 38

komunitetin e tyre. 32.0 përqind e femrave perceptuan 'grabitjen dhe vjedhjen' dhe vetëm 8.0 përqind perceptuan 'kërcënimin me armë' si krimet më të shpeshta.

Përkundër kësaj, më shumë të intervistuar femra (5.7 përqind) perceptuan sulmin/rrahjet si krim që ndodh më shpesh në komunitetin e tyre në krahasim me meshkujt (4.3 përqind). Çuditërisht, një përqindje shumë e madhe e femrave (38.3 përqind) u përgjigjën 'nuk di' në këtë pyetje në krahasim me meshkujt (28.9 përqind), duke treguar mundësinë se femrat në krahasim me meshkujt nuk ndjehen rehatshëm kur diskutojnë mbi çështjet e krimit dhe sigurisë në komunitetet e tyre.




Figura 9: Ndikimi i gjinisë në perceptimet mbi krimin e ndodhur më shpesh (mundësi për më shumë përgjigje)
Numri bazë: 1,153

Shqetësimet mbi sigurinë

Në pyetjen 'Sipas mendimit tuaj cilat janë tri shqetësimet më serioze të çështjes së sigurisë me të cilat ballafaqohet komuniteti juaj?', problemet trafikore (20.9 përqind), marrëdhëniet e dobëta ndëretnike (12 përqind) dhe shëndetësia (10.8 përqind) u identifikuan në përgjithësi si shqetësimet më të mëdha. Një pjesëmarrës i fokus grupit me Shqiptarë të Kosovës në Gjilan, një komunë me shumë etni, deklaroi se "nuk ka kërcënimet e krimit në lagjen time dhe siguria nuk është problem. Problemi më i dukshëm është trafiku". Sidoqoftë, shqetësimet mbi nivelin e krimit dhe marrëdhëniet e dobëta ndëretnike u dalluan më shumë në mesin e Serbëve të Kosovës se tek të intervistuarit tjerë.

56.9 e të intervistuarve Serbë të Kosovës identifikuan marrëdhëniet e dobëta ndëretnike si shqetësimin e tyre kryesor, pas të cilëve janë 8.4 përqind të cilët identifikuan si shqetësim kryesor nivelet e larta të krimit dhe 7.9 përqind të cilët identifikuan si shqetësim kryesor aktivitetet e grupeve kriminale. Për më shumë, derisa problemet e lidhura me armë u priorizuan nga shumë pak të intervistuar Shqiptarë të Kosovës, 7.4 përqind e të intervistuarve Serbë të Kosovës identifikuan këtë si shqetësimin më kryesor të sigurisë, dhe 21.8 përqind e identifikuan si problemin e dytë më serioz të sigurisë me të cilin ballafaqohet komuniteti i tyre. Këto gjetje mbështeten nga fokus grup diskutimet. Për shembull, gjatë një fokus grup diskutimi me Serbë të Kosovës në Mitrovicën Veriore, një femër 22 vjeçare theksoi 'hedhjen e bombave dhe të shtënat nga lloje të ndryshme të armëve' si shqetësimin më të madh të sigurisë.

Derisa nuk kishte dallime të mëdha në vlerësimin e shqetësimeve më të shpeshta nga femrat dhe meshkujt, meshkujt dy herë më shumë se femrat janë të prirur të konsiderojnë marrëdhëniet e dobëta etnike si shqetësimin më të rëndësishëm të sigurisë, ku 15.3 përqind e meshkujve dhe 7.7 përqind e femrave identifikuan këtë si shqetësimin e tyre kryesor.

Ndryshimet në përceptimet mbi sigurinë

Kur u pyetën për efektin e statusit përfundimtar të Kosovës në sigurinë e tyre, të intervistuarit ofruan vështrime të polarizuara. 73.2 përqind e të intervistuarve Shqiptarë të Kosovës dhe minoriteteve jo-Serbe besuan se do të përmirësonte sigurinë e tyre 'pak' ose 'shumë', dhe vetëm 7.4 përqind konsideruan se siguria e tyre do të zvogëlohej si rezultat i kësaj. Sidoqoftë, kjo ndryshonte tek të intervistuarit Serbë të Kosovës, ku vetëm 1 përqind besonin se statusi përfundimtar do të rezultonte me përmirësim të sigurisë së tyre, dhe 78.2 përqind besonin se siguria e tyre do të zvogëlohej.

Çuditërisht, edhe të intervistuarit të cilët shprehën qëllimin e emigrimit nga Kosova brenda pesë viteve të ardhshme mendonin se zgjidhja e statusit përfundimtar të Kosovës do të përmirësonte sigurinë e tyre. Një total prej 64.7 përqind e atyre të cilët planifikojnë të emigrojnë konsideruan se siguria e tyre do të përmirësohej 'pak' ose 'shumë' me zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, dhe vetëm 12.6 përqind mendonin se do të 'ulej' ose 'do të ulej shumë'. Kjo krahasohet me 18.8 përqind e atyre të intervistuarve të cilët deklaruan se nuk kanë për qëllim të emigrojnë gjatë pesë viteve të ardhshme të cilët besonin se zgjidhja e statusit përfundimtar të Kosovës do të rezultojë me ulje të vogël të sigurisë së tyre, dhe 31.1 përqind të atyre që mbetën të pavendosur nëse do të emigronin.

Pas zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës, UNMIK-u gradualisht do të zëvendësohet nga misioni civil i udhëhequr nga BE-ja. Ka pasur shqetësime të mëdha në lidhje me punën e UNMIK-ut, dhe është interesante që 39.5 përqind e të intervistuarve besojnë se prania e re ndërkombëtare do të çojë drejt përmirësimit të sigurisë së tyre personale, ose 'pak' (22.6 përqind) ose 'shumë' (16.9 përqind). Në lidhje me këtë, në një fokus grup të kryer në Mitrovicën Veriore, një studente 24 vjeçare komentoi, "Besoj se do të ketë ndryshime pozitive në drejtimin e zhvillimit ekonomik dhe agrar pasi prania KB-së të zëvendësohet me atë të BE-së". Gati gjysma e të intervistuarve mendonin që ndryshimi i pranisë ndërkombëtare nuk do të ketë efekt në sigurinë e tyre (22.5 përqind) ose nuk dinin se çfarë efekti mund të ketë (22.3 përqind), por vetëm 13.8 përqind besonin se kjo do të rezultonte me një ulje të sigurisë. Serbët e Kosovës janë shumë më pak optimist se Shqiptarët e Kosovës në lidhje me paraqitjen e pranisë së re të udhëhequr nga BE-ja në

Kosovë: gati gjysma (49.1 përqind) besonin se siguria e tyre do të ulej kur kjo të ndodh. Edhe pse një përqindje e rëndësishme (20.8 përqind) mendojnë se siguria e tyre do të mbetet e njëjtë, vetëm 3.5 përqind mendojnë se kalimi nga UNMIK-u tek BE-ja do të rezultojë me një ambient më të sigurt për ta.

Sidomos në disa komuna një proporcion i rëndësishëm i të intervistuarve ndjeheshin se ambienti do të bëhej më i pasigurt me praninë e misionit të udhëhequr nga BE-ja në Kosovë. Në Shtërpcë, 87.5 përqind e të intervistuarve mendonin se ndërrimi i misionit do të çoj drejt dëmtimit të sigurisë së tyre, dhe 43.4 përqind e të intervistuarve në Zveçan dhe 39.1 përqind e të intervistuarve në Leposaviq kishin këtë vështrim. Të tri komunat kanë shumicë Serbë të Kosovës, por derisa Zveçani dhe Leposaviqi janë në veri të Kosovës, në kufi me Serbinë, Shtërpcë, ku shumica e popullatës Serbe jetojnë në enklava, është në jug, në kufi me Maqedoninë.¹²

Veç kësaj, edhe pse proporcione të rëndësishme të intervistuarve nga këto tri komuna ndjeheshin se nivelet e sigurisë do të uleshin nën misionin e udhëhequr nga BE-ja, ata janë gjithashtu negativ në përgjithësi në perceptimet e tyre mbi Policinë e UNMIK-ut dhe KFOR-in. Vetëm në Shtërpcë një numër i rëndësishëm i të intervistuarve (31.3 përqind) deklaruan se i besonin plotësisht Policisë së UNMIK-ut.




Figura 10: Në vitin 2007, UNMIK-u pritet të zëvendësohet nga prania e re e BE-së. Si mendoni se do të ndikohet siguria juaj nga kjo prani e re ndërkombëtare?
Numri bazë: 1,120

¹² Misioni i OSBE-së në Kosovës, *Profili Komunal: Shtërpcë* (Maj 2006). Mund të gjendet në: http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/1203_en.pdf dhe *Profili Komunal: Leposaviq* (Maj 2006), që mund të gjendet në: http://www.osce.org/documents/mik/2005/12/1192_en.pdf

Perceptimet mbi konfliktin

Perceptimet e sigurisë në nivelin lokal dhe komunal shpesh janë të lidhura me perceptimet e konfliktit në Kosovë në përgjithësi. 36.8 përqind e të pyeturve besojnë se një konflikt tjetër i dhunshëm 'ka gjasa' dhe 'ka shumë gjasa' të ndodhë në Kosovë gjatë pesë viteve të fundit. Vetëm 24.6 përqind e të intervistuarve konsideruan një konflikt tjetër si 'me pak gjasa' ose 'nuk ka gjasa'. Perceptimi se një konflikt tjetër mund të ndodhë ishte më i theksuar në mesin e Serbëve të Kosovës, ku 52.5 përqind e atyre të pyetur konsideruan se 'ka gjasa' ose 'ka shumë gjasa'. Sidoqoftë, një pakicë e rëndësishme prej 33.5 përqind e Shqiptarëve të Kosovës dhe minoriteteve jo-Serbe gjithashtu mendojnë të njëjtën. Siç shihet në Figurën 11 më poshtë dallimet në mes grupeve etnike të ndryshme në lidhje me gjasat e perceptuara të ndodhisë së një konflikti të ardhshëm nuk janë të theksuara si në çështjet tjera të lidhura me sigurinë.




Figura 11: Sipas mendimit tuaj, sa ka gjasa që Kosova të ketë një konflikt tjetër të dhunshëm në pesë vitet e ardhshme?
Numri bazë: 1,153

Perceptimet se sa ka gjasa që Kosova të ketë një konflikt tjetër të dhunshëm në 5 vitet e ardhshme ndryshonin varësisht prej vendit të intervistuarve. Derisa shumë komuna treguan perceptime të ndryshme (si Mitrovica, Prishtina, dhe Prizreni), kishte komuna të cilat kishin perceptime kryesisht negative ose pozitive në lidhje me mundësinë e ndodhisë së ndonjë konflikti tjetër të dhunshëm. Figura 12 më poshtë ilustron gjashtë komunat ku proporcioni më i madh i të intervistuarve deklaruan se mendonin se 'ka shumë gjasa' ose 'nuk ka gjasa' që Kosova t'i kthehet konfliktit të dhunshëm. Dy nga tri komunat në të cilat proporcioni më i madh i të intervistuarve ndjeheshin se 'ka shumë gjasa' që Kosova t'i kthehet konfliktit të dhunshëm janë kryesisht të banuara nga Serbët e Kosovës (Zveçani dhe Zubin Potoku), dhe tri komunat ku proporcioni më i madh i të intervistuarve ndjeheshin se 'nuk ka gjasa' që Kosova t'i kthehet konfliktit të dhunshëm janë kryesisht të banuara nga Shqiptarët e Kosovës.




Figura 12: Sipas mendimit tuaj, sa ka gjasa që Kosova të ketë një konflikt tjetër të dhunshëm në pesë vitet e ardhshme?
Numri bazë: 64

Hulumtimi gjithashtu tregon se popullsia më e moshuar besojnë më shumë se popullsia e re që Kosova do të ketë një konflikt tjetër të dhunshëm gjatë pesë viteve të ardhshme. 25.5 përqind e të intervistuarve që janë në kategorinë e moshës 18-24 ndjeheshin se kjo 'nuk ka gjasa' në krahasim me 11.8 përqind të intervistuarve që janë të kategorinë e moshës 55+. Hulumtimi gjithashtu tregon që të rinjtë kanë më shumë besim se të moshuarit që konfliktet në komunitetin e tyre mund të zgjidhen në mënyrë paqësore. 21.6 përqind e të intervistuarve që janë të kategorinë e moshës më të re 18-24 kishin 'shumë besim' në krahasim me 14.6 përqind të intervistuarve që janë në kategorinë e moshës 55+.

Kur u pyetën mbi konfliktet e mundshme brenda komunitetit të tyre, një shumicë prej 62.4 përqind e të intervistuarve mendonin se mund të zgjidhen në mënyrë paqësore; vetëm 10.9 përqind kishin besim të ulët ose nuk kishin fare besim në kapacitetin e komuniteteve të tyre që të ballafaqohen me këtë lloj konflikti. Përsëri, Serbët e Kosovës shprehën besim shumë më të ulët në këtë çështje, ku vetëm 10.9 përqind e të intervistuarve deklaruan se 'kanë shumë besim' ose 'kanë besim'. Për shembull, në komunën e Leposaviqit, me shumicë Serbe, vetëm 4.3 përqind e të intervistuarve deklaruan se kanë shumë besim, 8.7 përqind kanë besim, dhe 39.1 përqind 'as kanë as nuk kanë besim'. E njëjta ishte edhe në Zubin Potok, ku shumica (68.8 përqind) e të intervistuarve deklaruan se 'as kanë as nuk kanë besim', 6.3 përqind 'kanë shumë besim' dhe askush nuk deklaroi që 'kanë besim'. Sidoqoftë, në komunën e Kamenicës, e cila ka popullsinë me etni të përzier, shumica e të intervistuarve deklaruan se 'kanë besim' (63.3 përqind) dhe 23.3 përqind deklaruan se 'kanë shumë besim' që konfliktet në komunitetin e tyre mund të zgjidhen në mënyrë paqësore. Në këtë komunë, një shumicë e madhe e pjesëmarrësve të fokus grupeve në mars të vitit 2007 konsideruan marrëdhëniet e tyre si të mira.

Shkaqet e konfliktit

Në përgjithësi, faktorët kryesor të identifikuar nga të intervistuarit si shkaqet më të mundshme të konfliktit të ardhshëm ishin statusi i pazgjidhur i Kosovës dhe çështjet ekonomike dhe sociale (papunësia dhe varfëria), ku gjithashtu u nxorën edhe qëndrimet e

politikanëve dhe deklaratat politike që përmendin ndarjen etnike (shih Figurën 13 më poshtë).




Figura 13: Cilët faktorë mendoni se kanë më shumë potencial të shkaktojnë konflikt në të ardhmen?
Numri bazë: 1,153

Ekzistojnë ndryshime të rëndësishme dhe të dukshme të perceptimeve mbi shkaqet kryesore të mundshme të shkaktojnë konflikt të ardhshëm në mes Shqiptarëve të Kosovës dhe Serbëve të Kosovës. 61.2 përqind e të intervistuarve Shqiptarë të Kosovës besonin se statusi i pazgjdhur i Kosovës është faktori më i rëndësishëm i cili mund të çoj drejt konfliktit në të ardhmen (ku 20.1 përqind tjerë e përcaktuan si faktorin e dytë ose të tretë më të rëndësishëm), përdërisa gati 10 përqind besonin se papunësia është faktori më i rëndësishëm që mund të çoj drejt trazirave në të ardhmen, dhe 54.7 përqind e përcaktuan atë si faktorin potencial më të rëndësishëm të dytë apo të tretë. Kjo dallon me perceptimet e Serbëve të Kosovës, 20.8 përqind e të cilëve përcaktuan statusin e pazgjdhur të Kosovës si faktorin e parë kryesor i cili mund të çoj drejt konfliktit. Gati gjysma e të intervistuarve Serbë të Kosovës (46.5 përqind) besonin se qëndrimi i politikanëve në Prishtinë ishte faktori i vetëm i cili mund të shkaktoj konflikt në të ardhmen, ku 24.8 përqind besonin se ishte shkak i dytë apo i tretë për nga rëndësia. Derisa asnjë nga të intervistuarit Serbë të Kosovës nuk besonin se qëndrimi i politikanëve në Beograd mund të jetë shkak më i rëndësishëm, 7.9 përqind e panë atë si faktorin e dytë për nga rëndësia, dhe 15.8 përqind mendonin se ishte faktori i trete për nga rëndësia.

Sidoqoftë, fokus grup diskutimet ofrojnë një perceptim të ndryshim në lidhje me këtë pyetje. Në fokus grup diskutimet me Serbë të Kosovës në Mitrovicën Veriore dhe Obiliq, pjesëmarrësit identifikuan statusin përfundimtar dhe papunësinë si faktorët me më shumë mundësi për nxitjen e konfliktit në të ardhmen, dhe nuk theksuan qëndrimet e politikanëve se faktor kontribuues. Kjo mund të jetë e lidhur me vështirësinë e 'mendimit në grup' që lidhet me fokus grupe, ku qëndrimet e njërit ose disa pjesëmarrësve mund të dominojnë diskutimet në grup dhe mund t'i dekurajojnë pjesëmarrësit e tjerë që të tregojnë vështrimet e pavarura.

Është interesante të përmendet se një proporcion i madh i të intervistuarve që janë në kategorinë e moshës më të re (13.8 përqind) perceptuan papunësinë si shkaktarin më të rëndësishëm të konfliktit në të ardhmen në krahasim me proporcionin e të intervistuarve që janë në kategorinë e moshës më të vjetër 55+ (8.7 përqind). Ka gjasa që kjo ndodh për shkak se papunësia ndikon sidomos në jetën e të rinjve në Kosovë.

Fokus grup diskutimet ilustronë këtë pikë më shumë. Gjatë diskutimit të mbajtur në Mitrovicën Veriore në dhjetor të vitit 2006, një pjesëmarrës mashkull 32 vjeçar komentoi, “ka shumë gjasa që konflikti të provokohet nga niveli i lartë i papunësisë, pasi që gjenerata e cila aktualisht është duke kryer shkollën e mesme dhe fakultetin e kanë shumë të vështirë të gjejnë punë”.

Perceptimet mbi garantuesit e sigurisë

Hulumtimi tregon që shumica e njerëzve në Kosovë kanë nivel të ulët të besimit në Policinë e UNMIK-ut dhe në gjyqësi; vetëm 5 përqind e të intervistuarve i besojnë 'plotësisht' Policisë së UNMIK-ut dhe 4.4 përqind i 'besojnë plotësisht' gjyqësisë. Shqiptarët e Kosovës raportojnë një shkallë më të lartë të besimit në ShPK-në më shumë se në garantuesit tjerë të sigurisë. Për shembull, një femër 25 vjeçare pjesëmarrëse në fokus grup diskutimet në Mitrovicën Veriore deklaroi se 'ShPK-ja dhe garantuesit tjerë të sigurisë nuk inspirojnë shumë besim tek populli Serb'.

Shumica e të intervistuarve (49.8 përqind) deklaruan se së pari do të thërrisnin ShPK-në nëse ata ose familja e tyre do të kërcënohej me dhunë. Një proporcion shumë i vogël i të intervistuarve deklaruan se ata së pari do të thërrisnin KFOR-in (1.6 përqind) dhe Policinë e UNMIK-ut (0.3 përqind). Çuditërisht, 1.4 përqind e të intervistuarve deklaruan që do të thërrisnin Trupat Mbrojtëse të Kosovës, edhe pse organizmat civil të emergjencës nuk kanë ndonjë rol në masat e sigurisë. Një proporcion i rëndësishëm i të intervistuarve deklaruan se do të vetëmbroheshin (19.1 përqind) ose do të thërrisnin familjen ose miqtë (28.3 përqind).¹³

Është interesante të tregohet që një proporcion i madh i femrave (55.1 përqind) më shumë se meshkujt (45.6 përqind) deklaruan se do të thërrisnin së pari ShPK-në nëse ata ose familja e tyre do të kërcënohej me dhunë. Për dallim, një proporcion i meshkujve (23.3 përqind) më shumë se femrat (13.6 përqind) deklaruan se nuk do të thërrisnin askënd nëse ata ose familja e tyre do të kërcënohej me dhunë dhe 'do të mbronin veten/familjen e tyre'.

Të intervistuarit e kategorisë së moshës më të re (18-24) kishin më shumë besim tek ShPK-ja se të intervistuarit e kategorisë më të vjetër (55+). 33.3 përqind e të intervistuarve të rinj deklaruan se ata i besojnë 'plotësisht' ShPK-së. Për dallim, vetëm 23.3 përqind e të intervistuarve mbi moshën 55 vjeçare i besonin plotësisht ShPK-së. Sidoqoftë, vetëm 2 përqind e grup moshës më të re i besonin plotësisht Policisë së UNMIK-ut në krahasim me 5.9 përqind të grup moshës më të vjetër. Të intervistuarit nga grup moshë më e re gjithashtu i besonin 'plotësisht' TMK-së më shumë se grup moshë më e vjetër, me 43.1 përqind të të rinjve dhe 34.8 përqind të më të moshuarve.

¹³ Të intervistuarit u lejuan të zgjedhin më shumë se një përgjigje për këtë pyetje.




Figura 14: Ata që i janë përgjigjur 'plotësisht' pyetjes 'Sa besim keni tek ShPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut dhe TMK-ja?'
Numri bazë: 1,153

Derisa policia civile ndërkombëtare, e udhëhequr nga UNMIK-u, mbanë përgjegjësinë për një numër të kufizuar të funksioneve policore me rrezik të madh dhe për hetimin e krimeve serioze si korrupsioni, përveç ofrimit të monitorimit, ndërtimit të kapacitetit dhe mbështetjes së policisë për homologët e tyre Kosovar, ShPK-ja është duke marrë rolin udhëheqës në të gjitha aspektet e policisë në Kosovë, përfshirë policinë kufitare, luftimin e mashtrimit dhe policinë e komunitetit. Sidoqoftë, ShPK-ja mbetet e varur nga Komisionari i Policisë së UNMIK-ut i cili ka autoritetin mbi policinë ndërkombëtare dhe Kosovare.

Gati gjysma e të intervistuarve nuk e kishin të qartë ndarjen e roleve në mes Policisë së UNMIK-ut dhe ShPK-së. 45.8 përqind e atyre që ju shtrua pyetja deklaruan se 'nuk e kishin të qartë' ose 'nuk e kishin aspak të qartë' ndarjen e roleve dhe përgjegjësi në mes Policisë së UNMIK-ut dhe ShPK-së. Rezultatet e fokus grup diskutimeve gjithashtu mbështetnin këtë pikë. Për shembull, një mashkull 21 vjeçar, pjesëmarrës në një fokus grup të mbajtur në Prishtinë deklaroi se "problemi më i madh është që nuk janë qartësuar kompetencat në lidhje me masat e sigurisë dhe ka konflikt të interesit në mes UNMIK-ut dhe institucioneve lokale".

Shërbimi Policor i Kosovës

Madhësia e shembullit për këtë studim ishte pak më e vogël se ajo e ndërmarrë në mars të vitit 2006 për *Hulumtimin e AVL-ve në Kosovë*¹⁴, por krahasimi në mes këtyre dy studimeve është vetëm informativ.

Një hulumtim i mëhershëm i kryer nga Saferworld dhe FIQ në vitin 2006 zbuloi një shkallë të rëndësishme të mosbesimit dhe dyshimit në aftësinë dhe/ose dëshirën e ShPK-së që të luftoj krimin në mënyrë pro-aktive, sidomos në mesin e Serbëve të Kosovës, edhe pse grupet tjera etnike ishin më pozitive me qëndrimet e tyre.¹⁵

Ekziston një rritje e dukshme në perceptimet e efikasitetit të policisë në studimin aktual. Kur u pyetën sa efikase e konsiderojnë policinë, 9.9 përqind e të intervistuarve u përgjigjen 'shumë efikase' dhe 27.6 përqind 'efikase' në mars të vitit 2006. Në hulumtimin për këtë studim gati gjysma e të intervistuarve (47.9 përqind) konsideronin ShPK-në¹⁶ si 'shumë efikase' ose 'efikase'. Kjo shifër vije kryesisht si rezultat i qëndrimeve të shprehura nga Shqiptarët e Kosovës, pasi që vetëm 4.0 përqind e Serbëve të Kosovës të pyetur perceptuan se ShPK-ja ishte 'efikase', me një total prej 51.5 përqind të tyre të cilët besonin se janë 'joefikas' ose 'shumë joefikas'.

Gjatë fokus grup diskutimeve në Mitrovicën Veriore, një mashkull 25 vjeçar Serb i Kosovës deklaroi se ShPK-ja nuk merr masa për përmirësimin e sigurisë së komunitetit Serb dhe nuk kryen punën e tyre si duhet. Për dallim, gjatë një fokus grupi të kryer në Prizren, një mashkull 41 vjeçar, Shqiptar i Kosovës, deklaroi se ShPK-ja ishte në përgjithësi efikase dhe transparente, derisa një femër 30 vjeçare, pjesëmarrëse në fokus grup diskutimin në Gjilan deklaroi se "ShPK-ja janë efikas por kanë nevojë të bashkëpunojnë më ngushtë me qytetarët". Një femër tjetër 20 vjeçare, pjesëmarrëse në të njëjtin fokus grup deklaroi që "qytetarët nuk bashkëpunojnë me policinë, dhe se policia nuk mund të dijë gjithçka në lidhje me një krim nëse qytetarët nuk bashkëpunojnë dhe nëse nuk i ndajnë informacionet me ta".

Perceptimet e efikasitet pasqyrohen nga nivelet e besimit të cilin njerëzit duket të kenë tek ShPK-ja. Në përgjithësi, këto janë mjaft të larta, ku 53.9 përqind e të intervistuarve deklaruan se i besojnë ShPK-së 'shumë' ose 'plotësisht' dhe 22.5 përqind tjerë shkallën e besimit në institucione e vendosin në 'mesatarisht'. Sidoqoftë, kjo ndryshon varësisht prej etnisë, ku vetëm 10.4 përqind e Serbëve të Kosovës i besojnë ShPK-së 'shumë' ose 'plotësisht'. Në fakt, 74.1 përqind e të intervistuarve Serbë të Kosovës deklaruan se i besojnë ShPK-së 'vetëm pak' ose 'aspak', siç edhe mund të shihet në Figurën 15 më poshtë.

¹⁴ Madhësia e shembullit për *Hulumtimin e AVL-ve në Kosovës* (shih f 46 të Hulumtimit të AVL-ve) ishte 1,258 ndërsa ajo për këtë studim ishte 1,153.

¹⁵ Shih Sokolová, J. et. al., *Hulumtimi i AVL-ve në Kosovë*, op. cit., pp 45-46 për më shumë detaje.

¹⁶ Duhet përmendur që Hulumtimi i AVL-ve i referohej 'policisë' ndërsa studimi aktual i referohet specifikisht ShPK-së.




Figura 15: Sa besim keni tek ShPK-ja?
Numri bazë: 1,153

Perceptimet se sa meritojnë besimin ShPK-ja gjithashtu ndryshonin varësisht prej vendit të intervistuarve. Derisa shumë komuna shfaqën perceptimet të ndryshme (si Ferizaj, Mitrovica, Prishtina dhe Obiliqi), kishte vende të caktuara të cilat kishin perceptime veçanërisht pozitive ose negative ndaj ShPK-së. Figura 16 më poshtë i detajizon vendet në Kosovë ku proporcioni më i madh i të intervistuarve deklaruan se besonin në ShPK 'plotësisht' ose 'shumë', dhe vendet ku proporcioni më i madh i të intervistuarve kishte pak ose aspak besim në këtë institucion.




Figura 16: Komunat në të cilat besimi në ShPK-në është më i larti dhe me i ulëti
Numri bazë: 132

Është interesante të përmendet që perceptimet se puna e ShPK-së i nënshtrohet ndikimit politik ishin mjaft të përhapura në mesin e të intervistuarve: gati gjysma (47.6 përqind) e të intervistuarve mendonin që puna e ShPK-së është e ndikuar deri diku nga partitë politike. Ky vështrim ishte më dominues në mesin e Serbëve të Kosovës, duke reflektuar kështu nivelin e ulët të besimit në punën e ShPK-së të shprehur nga të intervistuarit nga ky grup etnik, siç u cek më lartë. Sidoqoftë, pyetja nuk pati dallim në mes perceptimeve mbi ndikimin politik në punën e policisë në nivelin komunal dhe punën e ShPK-së si një institucion i tërë.¹⁷

¹⁷ Fokus grup diskutimet e kryera për hulumtimin e mëhershëm tregojnë se njerëzit ndërlidhin ndikimin politik në punën e policisë më shumë me policinë e tyre lokale se më ShPK-në si institucion i tërë.

Pjesëmarrësit e fokus grupit të mbajtur në Prishtinë theksuan disa situata ku krimet janë raportuar dhe hetimet nga ShPK-ja nuk janë kompletuar ose autori i krimit nuk është marrë në pyetje e as gjykuar në gjyq. Pjesëmarrësit mendonin se kjo shpesh ishte e lidhur me mbrojtjen e kriminelëve të caktuar nga ShPK-ja, për shembull të atyre me status të lart shoqëror. Pjesëmarrësit theksuan që kjo ka çuar drejt një situatë ku shumë njerëz mendojnë se ShPK-ja nuk mund t'i mbrojë ata dhe si rezultat i kësaj ata ndihen të frikësuar për të raportuar rastet ose për t'u paraqitur si dëshmitarë në gjyq. Për shembull, një pjesëmarrës mashkull 21 vjeçar deklaroi se "ekzistojnë disa raste kriminale në Kosovë për të cilat policia është në dijeni por nuk i hetojnë e as nuk i zgjidhin".

Hulumtimi tregon që njerëzit më të pasur dhe më të edukuar mendojnë më shumë se partitë politike kanë ndikim të madh në punën e ShPK-së, për dallim nga të rinjtë dhe ata më të varfër. Vetëm 3.2 përqind e të intervistuarve 'pa edukim formal' u pajtuan 'plotësisht' me deklaratën se partitë politike kanë ndikim në ShPK-në, në krahasim me 10.4 përqind e të intervistuarve të cilët kishin 'kryer fakultetin'. Vetëm 4.7 përqind e të intervistuarve që janë në kategorinë me të ardhurat më të vogla pajtohen që partitë politike kanë ndikim në ShPK, në krahasim me 20.5 përqind të intervistuarve të cilët janë në kategorinë me të ardhurat më të mëdha.

Ekziston një lidhje e parashikueshme në mes perceptimeve mbi efikasitetin dhe nivelin e besimit në ShPK-në. Për më tepër, ata të intervistuar të cilët perceptuan ShPK-në si joefikase në nivele të ndryshme ishin më hezitues në kontaktimin e tyre në rast të kërcënimit të dhunshëm. Të intervistuarit të cilët konsideronin ShPK-në si 'joefikase' ose 'shumë joefikase' ishin gjithashtu më të prirur që të deklarojnë se do të mbronin veten, ose do të kontaktonin të afërmit, miqtë dhe fqinjët dhe nuk do të thërrisnin ShPK-në në rast se do të kërcënoheshin me dhunë.

Trupat Mbrojtëse të Kosovës¹⁸

Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës qartë kërkon shpërbërjen e TMK-së brenda një viti pas përfundimit të periudhës së tranzicionit. I njëjti kushte deklaroi që është përgjegjësi e bashkësisë ndërkombëtare të krijoj një program të demobilizimit dhe riintegritimit në mënyrë që të lehtësohet e njëjta.

TMK-ja është krijuar për të lehtësuar shpërbërjen e UÇK-së dhe shumë ish-anëtarë të UÇK-së u punësuan në këtë institucion të ri civil emergjent, i cili kishte si standard që të jetë shumetnik dhe të përfaqësonte komunitete të ndryshme në Kosovë.¹⁹ Sidoqoftë, në sytë e shumë Shqiptarëve të Kosovës, TMK-ja mbetet pasardhëse e 'ushtrisë çlirimtare', derisa shumë Serbë të Kosovës vazhdojnë ta shohin me dyshim (dhe) si një 'forcë armike' (edhe pse kryen shërbime publike në shumë komuna të ndryshme).

Të intervistuarit Serbë të Kosovës në mënyrë tipike marrin parasysh institucionet e Kosovës më pak se Shqiptarët e Kosovës, por qëndrimet e tyre ndaj TMK-së janë veçanërisht negative. Ndoshta joçuditërisht, Serbët e Kosovës të intervistuar për këtë hulumtim shfaqën një nivel shumë të ulët të besimit në TMK-në, me 86.6 përqind që deklaruan se nuk i besonin këtij institucioni aspak. Kjo dallonte me 79.1 përqind të

¹⁸ Edhe pse Trupat Mbrojtëse të Kosovës nuk kanë kompetenca për masa të sigurisë, përsëri kanë një rol mbrojtës në raste të emergjencave civile, ashtu si edhe trajtohet në këtë seksion të raportit.

¹⁹ Shih për shembull *Çfarë ka ndodhur me UÇK-në?* (Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 2000). Mund të gjendet në: <http://www.crisisgroup.org/home/index.cfm?id=1582&l=1>; *Tunde qenin: Mobilizimi dhe demobilizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës* (Qendra Ndërkombëtare e Bonit për Shëndërrime, 2004). Mund të gjendet në: <http://www.bicc.de/publications/briefs/brief20/content.php>

Shqiptarëve të Kosovës dhe minoriteteve tjera jo-Serbe të cilët deklaruan se besojnë në TMK-në 'shumë' ose 'plotësisht'.

Ekzistojnë vende specifike në Kosovë ku nivelet e besimit në TMK janë veçanërisht të ulëta dhe veçanërisht të larta. Të gjithë të intervistuarit në Dragash dhe Skenderaj, dhe 96 përqind e të intervistuarve në Istog dhe Klinë, deklaruan që i besonin TMK-së 'plotësisht' ose 'shumë'. Për dallim, të gjithë të intervistuarit në Leposaviq, Shtërpçë, Zubin Potok dhe Zveçan deklaruan se kishin 'pak' besim në TMK-në, ose nuk i besonin aspak. Përsëri, ekzistojnë disa komuna, si Mitrovica dhe Prishtina ku ishin të pranishme perceptime të ndryshme.

Dyshimet e shumë Serbëve të Kosovës mbi qëllimet dhe tendencat e TMK-së reflektohen në faktin se 87.1 përqind e Serbëve të Kosovës të intervistuar për këtë hulumtim mendonin se kjo organizatë duhet shpërbërë. Vetëm 2.5 përqind mendonin se mund të kryej ndonjë funksion tjetër, si patrullim kufitar apo të veprojnë si forcë për mbrojtje civile. Shqiptarët e Kosovës dhe anëtarët e minoriteteve jo-Serbe, për dallim, ishin shumë më të prirur të konsiderojnë mundësinë që TMK-ja të transformohet në ushtri, për të cilën 85.9 përqind deklaruan se TMK-ja duhet të bëhet ushtri. Vetëm 0.1 përqind mendonin se duhet shpërbërë.²⁰

Këto qëndrime kryesisht të polarizuara gjithashtu reflektohen në perceptimet mbi demobilizimin e TMK-së. Derisa hulumtimi nuk kishte për qëllim identifikimin e perceptimeve të publikut mbi lidhjet specifike në mes UÇK-së dhe TMK-së, ai hulumtoi për mendimet e njerëzve mbi efektshmërinë e demobilizimit dhe riintegrimin në jetën civile të UÇK-së. Edhe pse Shqiptarët e Kosovës dhe anëtarët e minoriteteve jo-Serbe ishin kryesisht optimist, 98 përqind e të intervistuarve Serbë të Kosovës deklaruan se 'nuk pajtohen' ose 'nuk pajtohen aspak' me deklaratën që 'UÇK-ja është demobilizuar me efikasitet, dhe ish anëtarët i janë kthyer jetës civile'.

Informacionet mbi komunat në të cilat nivelet e besimit në TMK-në dukej se ishin veçanërisht të larta apo të ulëta korrespondojnë me shënimet në lidhje me perceptimet mbi demobilizimin e UÇK-së. Për shembull, në katër komunat ku të gjithë të intervistuarit kishin besim minimal ose nuk kishin aspak besim në TMK-në, proporcione shumë të larta të intervistuarve nuk pajtoheshin ose nuk pajtoheshin aspak me deklaratën që 'UÇK-ja është demobilizuar me efikasitet, dhe ish anëtarët i janë kthyer jetës civile'.

Gjyqësia²¹

Që të dy hulumtimet e ndërmarrë, *Hulumtimi i AVL-ve në Kosovë*²² në vitin 2006 dhe hulumtimi i drejtuar nga Instituti Demokratik Kombëtar në Kosovë në shkurt të vitit 2007²³ zbuloi nivele veçanërisht të ulëta në gjyqësi, duke reflektuar kështu një mungesë të përgjithshme të besimit në sundimin e ligjit në Kosovë. Hulumtimi i ndërmarrë për këtë studim mbështet këto gjetje, ku 37.4 përqind e të intervistuarve raportuan se nuk i besojnë gjyqësisë 'aspak' ose 'pak'.

²⁰ Grupi i Krizave pohon që një ushtri e Kosovës e krijuar "[pjesërisht] bazuar në TMK-në është një komponent kyç i strukturave të sigurisë pas pavarësisë". *Një Ushtri për Kosovën?* (Grupi i Krizave, Korrik 2006), p. i. Mund të gjendet në: <http://www.crisisgroup.org/home/index.cfm?id=4290&l=1>

²¹ Pasi që gjyqësia është një komponentë vitale në sigurimin e sundimit të ligjit dhe indirekt në sigurinë e njerëzve, ajo u trajtua në këtë seksion të raportit.

²² Sokolová, J. et. al. op. cit., pp 44-45

²³ *Depërtimi në opinionin publik* (Instituti Demokratik Ndërkombëtar, shkurt 2007).

Sidoqoftë, një proporcion i rëndësishëm i të intervistuarve për këtë studim deklaruan se i besonin gjyqësisë 'plotësisht' (4.4 përqind) ose 'shumë' (13.8). Përsëri, nivelet e besimit ndaj gjyqësisë të treguara nga të intervistuarit Serbë të Kosovës ishin shumë më të ulëta se të intervistuarit Shqiptarë të Kosovës dhe minoritetet jo-Serbe: vetëm 5.0 përqind e të intervistuarve Serbë të Kosovës i besonin gjyqësisë 'shumë' dhe asnjë nuk i besonte 'plotësisht', krahasuar me 25.4 përqind ('shumë') dhe 5.4 përqind (plotësisht) të intervistuarve Shqiptarë të Kosovës dhe minoriteteve jo-Serbe.

Garantuesit ndërkombëtar të sigurisë

Pas më shumë se shtatë viteve në Kosovë, si duket Policia e UNMIK-ut në përgjithësi nuk është e besueshme²⁴, ku shumica e njerëzve të pyetur deklaruan se kishin nivel 'mesatar' ose të ulët në këtë institucion. Në fakt, vetëm 19.7 përqind e të intervistuarve deklaruan se i besonin Policisë të UNMIK-ut 'plotësisht' ose 'shumë', dhe edhe pse 34.3 përqind deklaruan se i besonin këtij institucioni 'mesatarisht', 24.1 përqind i besonin Policisë së UNMIK-ut vetëm 'pak' dhe 18 përqind 'aspak'. Të intervistuarit në Dragash ishin veçanërisht pozitiv, ku 86.6 përqind treguan besim të plotë në Policinë e UNMIK-ut, ndërsa në Fushë Kosovë, Leposaviq dhe Zveçan niveli i besimit ishte veçanërisht i ulët.

Ky studim tregon që KFOR-i është më i besuar se Policia e UNMIK-ut. Pothuajse një çerek (23.9 përqind) e të intervistuarve kishin besim të plotë në praninë e ushtrisë ndërkombëtare, dhe 29.7 përqind tjerë i besonin 'shumë', dhe 24.9 përqind deklaruan që kishin besim 'mesatar' tek KFOR-i. Vetëm 19.3 përqind e të intervistuarve deklaruan se i besonin KFOR-it 'pak' ose 'aspak', që tregon një dallim shumë të madh me 42.1 përqind e të intervistuarve të cilët zgjedhën këto përgjigje për Policinë e UNMIK-ut. Këto ishin vendet në Kosovë në të cilat nivelet e besimit në KFOR ishin të larta, si Dragashi dhe Klina (të gjithë të intervistuarit deklaruan që i besonin KFOR-it 'plotësisht' ose 'shumë'), dhe vendet ku nivelet e besimit ishin veçanërisht të ulëta, si në Zveçan.

Sidoqoftë, ndryshe nga perceptimi për Policinë e UNMIK-ut, që ishte relativisht i qëndrueshëm përkundër etnisë së të intervistuarve, besimi në KFOR ndryshonte shumë varësisht prej etnisë së të intervistuarve, siç edhe mund të shihet në Figurën 17 më poshtë.




Figura 17: Sa besim keni tek KFOR-i?
Numri bazë: 1,153

²⁴ Pjesa më e madhe e hulumtimit për këtë studim është kryer në dhjetor të vitit 2006, dhe si pasojë rezultatet janë para ngjarjeve të 10 shkurtit 2007, ku dy protestues u vranë gjatë protestave në Prishtinë.

Fokus grupi i mbajtur në Mitrovicën Veriore theksoi nivelin e ulët të besimit që Serbët e Kosovës kanë për KFOR-in. Për shembull, një studente femër 25 vjeçare deklaroi se “KFOR-i nuk ndihmojnë – ata vetëm vëzhgojnë dhe reagojnë në dëm të komunitetit Serb”.

Këto shënime përputhen me ato të mbledhura gjatë *Hulumtimit të AVL-ve në Kosovë* në vitin 2006. Intervistat e kryera për këtë hulumtim tregojnë se ky nivel i ulët i besimit mund të vije si rezultat i perceptimit të mosveprimit të KFOR-it gjatë dhunës së marsit të vitit 2004, e cila rezultoi me vdekjen e 19 personave, dhe me shkatërrimin e pronës së Serbëve të Kosovës, kryesisht.²⁵ Sidoqoftë, përkundër demonstrimit të shënimeve të këtij hulumtimi që të intervistuarit Serbë të Kosovës kanë pak besim tek KFOR-i, Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, i publikuar nga UNDP-ja në shtator të vitit 2006 tregon se 83.6 përqind të njerëzve, përfshirë edhe 41.4 përqind të Serbëve të Kosovës, janë ose ‘të kënaqur’ ose ‘shumë të kënaqur’ me punën e KFOR-it.²⁶ Nivelet e besimit dhe kënaqësisë nuk janë domosdo të ndërvarura, por sidoqoftë është interesante që këto dy grupe të shënimeve zbulojnë qëndrime kaq të ndryshme.

Mekanizmat lokal dhe ndërkombëtar të sigurisë

Institucione të ndryshme janë themeluar në nivelet e komunës dhe qytetit në tërë Kosovës për të adresuar çështjet e sigurisë publike nga një perspektivë e orientuar drejt komunitetit. Pas Rregullores së UNMIK-ut në dhjetor të vitit 2006, u themelua nga një Këshill Komunal për Siguri në Komunitet (KKSK) në 30 komunat për të adresuar çështjet e sigurisë lokale në bashkëpunim me autoritetet komunale, komunitetet lokale dhe Shërbimin Policor të Kosovës. Veç kësaj, u krijuan rreth 15 Këshille Lokale për Siguri Publike (KLSP) në qytezat dhe fshatrat e zgjedhura të banuara nga komunitetet minoritare me qëllimin e afrimit të policisë tek këto komunitete dhe duke e bërë policinë më të përgjegjshme ndaj nevojave të posaçme të baronëve të komuniteteve. Sidoqoftë, edhe pse në dokumente këto institucione duhet të arrijnë shifra të mëdha të publikut Kosovar, në praktikë ky studim zbulon se informimi publik mbi KKSK-të dhe KLSP-të është tejet i kufizuar. Vetëm 6.9 përqind e të intervistuarve kishin dëgjuar për KLSP-të, dhe vetëm 2.9 përqind ishin të informuar mbi ekzistencën e KKSK-ve. Informimi ishte i dobët veçanërisht në komunat e Dragashit, Rahovecit dhe Zveçanit, ku të intervistuarit kishin dëgjuar për KLSP-të.²⁷

Fokus grupet përkrahin këto gjetje. Një mashkull 50 vjeçar pjesëmarrës në një fokus grup te kryer në Mitrovicën Veriore deklaroi, “Nuk kam dëgjuar se organizata Lokale Komunale të sigurisë operojnë dhe është shumë e mundshme që këto institucione ekzistojnë vetëm në letër”.²⁸

Kjo ide nuk është e njëjtë në tërë Kosovën. Të intervistuarit në Skenderaj, Zubin Potok dhe Ferizaj ishin më të informuarit me 20 përqind, 18.8 përqind dhe 18.5 përqind të

²⁵ Sokolová, J. et. al. op. cit, p 47

²⁶ *Raporti i Paralajmërimit të Hershëm Numër 14* (UNDP dhe USAID, korrik – shtator 2006), p4 dhe p41. Mund të gjendet në: http://www.ks.undp.org/repository/docs/eër14_eng.pdf

²⁷ Në kohën e studimit, një KLSP ekzistonte në Krushevë, në komunitetin Goran në komunën e Dragashit, si dhe në Hoçë të Madhe, një komunitet Serb në komunën e Rahovecit, por asnjë nuk ishte krijuar në komunën e Zveçanit.

²⁸ Edhe pse në teori një KKSK ishte themeluar për gjithë komunën e Mitrovicës, është e mundur që funksionimi i tij është dobësuar nga vështirësitë në përfshirjen e udhëheqësve dhe qytetarëve të Mitrovicës Veriore dhe Jugore.

intervistuarve në ato komuna të cilët kanë dijeni mbi KLSP-të. Sidoqoftë, ata të cilët kishin dëgjuar për KLSP-të nuk dinin nëse kishte ndonjë që operonte në vendin e tyre.

Ndryshe nga KLSP-të, dijenia mbi KKSK-të ishte edhe më e ulët, edhe pse KKSK-të duhen operuar në secilën komunë. Asnjë nga të intervistuarit në Dragash, Gjakovë, Kamenicë, Obiliq, Podujevë, Rahovec, Shtërpçë, Vushtri dhe Zveçan nuk kishin dëgjuar për KKSK-të. Prej 2.9 përqind të intervistuarve të cilët kishin dëgjuar për KKSK-të, më pak se gjysma dinin për ndonjë që operonte në vendin e tyre; e barabartë me 1.3 të të gjithë të intervistuarve. Në Skenderaj, Zubin Potok dhe Ferizaj, ku dijenia mbi KLSP-të ishte më e larta, dijenia mbi KKSK-të ishte më e ulët, me 10 përqind, 6.3 përqind dhe 0 përqind që kanë dijeni mbi KKSK-të

Të intervistuarit gjithashtu nuk dinin për Rishikimin e Sektorit të Sigurisë së Brendshme, një proces njëvjeçar i kryer në vitin 2006. Si projekt i përbashkët në mes UNMIK-ut, UNDP-së dhe IPVQ-ve, RSSB-ja kishte për qëllim ekzaminimin e nevojave të sigurisë së brendshme të Kosovës dhe ofrimin e rekomandimeve për zhvillimin e sektorit të sigurisë së Kosovës në pajtueshmëri me këto nevoja. Përkundër ndërmarrjes së asaj çfarë projekt grupi i RSSB-së e përshkroi si një 'proces i gjerë i këshillimit publik dhe qasjes në publik',²⁹ që përfshinë mbledhje në salla të qyteteve, debate televizive, shpërndarjen e 20,000 fletushkave, një total prej 1,039 pyetësorëve dhe aktiviteteve të udhëtimit të 'Autobusit Thuaje Mendimin Tënd',³⁰ si duket kishte nivel shumë të ulët të dijenisë mbi procesin e RSSB-së. Vetëm një nga të intervistuarit për këtë hulumtim deklaroi se kishte dëgjuar për RSSB-në, dhe 96.8 përqind deklaruan se nuk kishin dëgjuar.

Niveli shumë i ulët i dijenisë për një proces me një komponent kaq të madh të qasjes në publik është i habitshëm, por mund të jetë si rezultat i disa faktorëve. Së pari, hulumtimi për këtë studim u krye gjashtë muaj pas punës përfundimtare për qasje në publik të RSSB-së (që ndodhi në korrik 2006), dhe publiku mund të ketë harruar për procesin në kohën kur ky hulumtim është përfunduar. Ekipi i RSSB-së sugjeron që gjetjet mund të shpjegohen nga mënyra e kampanjës së tyre, e cila nuk kishte për qëllim të fitonte njohje të gjerë për RSSB-në, por të informohej mbi mendimet e publikut për masat e sigurisë në Kosovë. Veç kësaj, provat e kampanjave të bazuara në imazhin e RSSB-së mund të përfshijnë një dijeni më të gjerë të "kulturës popullore" mbi qëllimet e RSSB-së, nëse jo për akronimin e tij. Ekipi i RSSB-së deklaroi që janë "shumë të kënaqur" me komentet e publikut të pranuar gjatë kampanjës së qasjes në publik³¹. Megjithatë, niveli shumë i ulët i dijenisë për gjithë këto procese dhe struktura të orientuara drejt sigurisë paraqet një sfidë për institucionet qeveritare të Kosovës në ndonjë qasje të ardhme në publik.

Qëndrimet ndaj shërbimeve inteligjente

Pasqyra aktuale e inteligjencës në Kosovë është e karakterizuar nga organizata si Instituti për Hulumtimin Strategjik të Opinionit Publik (IHSOP) dhe Shërbimi Informativ i Kosovës, operimet e të cilave shpesh kanë ngjashmëri me shërbimet inteligjente por që nuk kanë mandat legjislativ për operim, si dhe "strukturat paralele" të lidhura me Beogradin të cilat operojnë kryesisht në veri të Lumit Ibër. Për plotësimin e këtij vakumi në mbledhjen

²⁹ *Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme* (RSSB), UNDP/RSSB p 3. Mund të gjendet në: http://www.issrkosovo.org/repository/docs/ISSR_report_eng_ver2.pdf

³⁰ Për detaje mbi metodologjinë e këshillimit publik dhe qasjes në publik, shih ibid. p5, dhe *Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme në Kosovë – Kampanja për Informim të Mediave* (UNDP/RSSB)

³¹ Intervistat me Izabella Cooper, Këshilltare për Komunikim në UNDP/RSSB dhe Michael von Tangen Page, Këshilltar për Zhvillimin e Sektorit të Sigurisë për RSSB-në, 20 prill 2007

legjislative të inteligjencës, Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i publikuar në shkurt të vitit 2007, propozon që Kosova të pajiset me një 'agjenci vendore të sigurimit për monitorimin e kërcënimeve ndaj sigurisë së brendshme të Kosovës'.³²

Kur u pyetën për këtë studim se si do të ndikonte një shërbim i ri zyrtar i inteligjencës i Kosovës në sigurinë e tyre, një proporcion i rëndësishëm i të intervistuarve (26.1 përqind) deklaruan se nuk dinin. Ndoshta çuditërisht, Shqiptarët e Kosovës mendonin që shërbimi inteligjent i Kosovës do të përmirësonte sigurinë e tyre, ose 'pak' (31.7 përqind) ose 'shumë' (28.6 përqind). Fokus grup diskutimet mbështesin këto gjetje. Për shembull, një femër 22 vjeçare, pjesëmarrëse në një fokus grup të kryer në Prishtinë, deklaroi se "Kosova ka nevojë për një shërbim inteligjent.... Nëse Kosova do të kishte një shërbim inteligjent atëherë do të parandaloheshin konfliktet e mundshme".

Për dallim, Serbët e Kosovës ishin pesimist, ku vetëm 4 përqind mendonin se një shërbim inteligjent do të përmirësonte sigurinë e tyre 'pak' ose 'shumë', dhe 28.7 përqind besonin që siguria e tyre do të ulej deri në një shkallë. Sidoqoftë, duhet përmendur që një proporcion veçanërisht i madh i të intervistuarve Serbë të Kosovës zgjedhën që mos të përgjigjeshin në këtë pyetje (32.7 përqind krahasuar me vetëm 3.3 përqind të intervistuarve Shqiptarë të Kosovës), dhe 31.7 përqind tjerë zgjedhën përgjigjen 'nuk di'.

Të intervistuarit shprehën qëndrime të njëjta në lidhje me nivelin e besimit që do të kishin në një shërbim inteligjent zyrtar. Përsëri, të intervistuarit Serbë të Kosovës treguan një tendencë drejt një besimit të kufizuar apo mosbesimit, derisa Shqiptarët e Kosovës ishin më pozitiv.

³² *Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës*, pp 50-51. Mund të gjendet në: http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf

Posedimi dhe përdorimi i armëve

Ky studim gjithashtu ka hulumtuar edhe mbi qëndrimet e qytetarëve drejt posedimit dhe përdorimit të armëve me qëllim të kuptimit pse njerëzit posedojnë armë dhe çfarë do t'i nxiste njerëzit që t'i dorëzonin ato. Për shkak të ndjeshmërisë së lartë të kësaj teme në shoqërinë Kosovare, studimet mbi perceptimet në lidhje me posedimin e armëve nuk kanë për qëllim të ofrojnë një pasqyrë të saktë të shpërndarjes së armëve në Kosovë pasi që të intervistuarit shfaqin nivele të larta të shqetësimit ose dyshimit për diskutimin e kësaj çështje. Sidoqoftë, ata përsëri ofrojnë një pasqyrë të dobishme të qëndrimeve që njerëzit kanë në Kosovë, dhe si të tilla përgjigjet e të intervistuarve janë interesante për ekzaminim dhe përcjellje gjatë kohës.

Tre-çerek të gjithë të intervistuarve për këtë studim deklaruan se nuk ishin në dijeni të ndonjë incidenti në komunitetin e tyre ku ndokush është lënduar nga armët e zjarrit, municionet ose eksplozivët në mes korrikut dhe dhjetorit të vitit 2006. Ata të cilët dinin për këto incidente, shumica (8 përqind) i lidhnin me të shtëna gjatë festimeve, vepra kriminale (4.3 përqind) dhe mosmarrëveshje pronësore (2.4 përqind). Sidoqoftë, ekziston një mospërputhje në mes përvojave të raportuara nga Shqiptarët e Kosovës dhe Serbët e Kosovës. Incidentet që përfshinin lëndime nga armët e zjarrit të përmendura nga Serbët e Kosovës ishin aktet kriminale (13.4 përqind e të intervistuarve Serbë të Kosovës). 8.5 përqind të intervistuarve Shqiptarë të Kosovës më shpesh përmendnin lëndimet si pasojë e të shtënave gjatë festimeve. Derisa 13 përqind të intervistuar tjerë Serbë të Kosovës përmendnin dikë në komunitetin e tyre të lënduar në gjashtë muajt e fundit si rezultat i një akti kriminal, vetëm 2.1 përqind e Shqiptarëve të Kosovës raportuan për incidente të këtij lloji.

Me ekzaminimin e shënimeve për komuna të ndryshme, është çuditëse të kuptohet që më shumë se një çerek i të intervistuarve në Mitrovicë (25.9 përqind) përmendin ndonjë person që ishte lënduar nga armët e zjarrit në akte kriminale gjatë korrikut-dhjetorit të vitit 2006, deri tani më shumë se në shumë komuna tjera. Për dallim, vetëm 6.1 përqind e të intervistuarve në Pejë përmendin incidente të këtij lloji. Kjo si duket është në kundërshtim me perceptimin e gjerë në Kosovë për Pejën si një vend me nivelet më të larta të krimit të armatosur. Sidoqoftë, rezultati përputhet me perceptimet e dhëna nga të intervistuarit që banojnë në Pejë në intervistat dhe fokus grupet e kryera në shkurt të vitit 2007, ku deklaruan se pjesa më e madhe e krimeve dhe dhunës me armë që kanë ndodhur në Pejë nuk kanë dëmtuar direkt komunitetet e tyre pasi që aktorët e krimit shpesh janë nga jashtë (që zgjidhin mosmarrëveshje) ose të lidhur me grupe të veçanta kriminale dhe interesat e tyre.

Pothuajse dy herë më shumë njerëz (48.7 përqind) besonin që posedimi i armëve të zjarrit nuk do t'i bënte ata të ndiheshin më të sigurt në krahasim me ata që besonin që do të ndiheshin më të sigurt (24.8 përqind), dhe 12.8 përqind tjerë deklarorin se nuk ndihen të sigurt. Nuk ka dallime të mëdha në perceptimet e të intervistuarve meshkuj dhe femra, me proporcione pak më të larta të femrave (28.1 përqind) që besonin se posedimi i armëve i bënë, ose do t'i bënte, familjet e tyre më të sigurta, krahasuar me 22.3 përqind të intervistuarve meshkuj, derisa një proporcion i madh i meshkujve besonin se nuk i bënë më të sigurt (14.7 përqind krahasuar me 10.5 përqind të femrave). Një nivel i barabartë i të intervistuarve meshkuj dhe femra besonin që posedimi i armëve të zjarrit nuk i bënë ose nuk do t'i bënte familjet e tyre më të sigurta.

Për dallim nga shënimet e përgjithshme, opinioni i shprehur më së shpeshti nga Serbët e Kosovës (43.6 përqind) ishte që posedimi i armëve të zjarrit nuk ka dallim në sigurinë familjare, ku vetëm 13.4 përqind qartë deklaruan se nuk i bënë familjet e tyre më të sigurt. Kjo përputhet me përgjigjet e dhëna në pyetjen "A do të merrnit një armë zjarri nëse do t'u paraqitej mundësia?" nga të intervistuarit Serbë të Kosovës, ku 49 përqind e tyre deklaruan se nuk dinë (derisa 20.3 përqind u përgjigjën 'po' dhe 13.4 përqind u përgjigjën 'jo'). Sidoqoftë, pothuajse 70 përqind e të intervistuarve Shqiptarë të Kosovës pohuan se nuk do të merrnin armë zjarri nëse do t'u paraqitej mundësia.

Nga ata të cilët deklaruan që do të merrnin armë zjarri nëse do t'u paraqitej mundësia, arsyet kryesore të raportuara për këtë, përveç vetëmbrojtjes, ishin mbrojtja e biznesit apo pronës (11 përqind), frika nga konflikti ose lufta (6.1 përqind), dhe gjuetia ose për gjuajtje sportive (3.7 përqind). Fokus grupi theksoi që shumë Shqiptarë të Kosovës perceptojnë traditën si arsyen kryesore pse njerëzit posedojnë armë. Për shembull, gjatë një fokus grup diskutimi në Gjilan, një pjesëmarrëse femër 25 vjeçare deklaroi që "shumica e njerëzve që posedojnë armë e bëjnë këtë për shkak të traditës".

Një proporcion dukshëm më i madh i të intervistuarve në kategorinë me të ardhura të larta zgjodhi 'frikën nga konflikti/lufta' si arsyen kryesore pse ata do të zgjidhnin të posedonin armë (33.3), ku kjo dallon me proporcionin e të intervistuarve të kategorisë me të ardhura më të ulëta (14.3 përqind). Gjithashtu është interesante të përmendet që një proporcioni i lartë i të intervistuarve në vendet rurale zgjodhën 'frikën nga konflikti/lufta' si arsyen kryesore pse ata do të zgjidhnin të posedonin një armë (22 përqind), që dallon me proporcionin në vendet urbane (17.2 përqind).

Fokus grupet theksuan besimin e pranishëm në mesin e Shqiptarëve të Kosovës dhe Serbëve të Kosovës se komunitetet e tyre posedojnë më pak armë se komunitetet "tjera" dhe se armët e poseduara në komunitetet e tyre janë legale dhe për arsye jokërcënuese si festimet, tradita ose gjuetia. Për shembull, gjatë një fokus grup diskutimi me Serbët e Kosovës në Obiliq, një pjesëmarrës mashkull 30 vjeçar deklaroi se "komuniteti Serb nuk posedon armë, përveç pushkëve të gjuetisë për të cilat kanë kartela për autorizim të armëve. Fatkeqësisht nuk është rasti i njëjtë në komunitetet Shqiptare të cilat posedojnë një numër më të madh të armëve". Gjatë një fokus grup diskutimi me Shqiptarët e Kosovës në Gjilan, një pjesëmarrëse femër 33 vjeçare deklaroi: "Nuk mendoj se Shqiptarët kanë shumë armë, por Serbët kanë. Shumica e Shqiptarëve janë kontrolluar për armë por fshatrat e banuara nga Serbët nuk janë kontrolluar fare".

Bazuar në perceptimet e raportuara për këtë studim, Serbët e Kosovës dëgjojnë më shumë të shtëna nga armët në lagjet e tyre se çdokush tjetër. Më shumë se një çerek i Serbëve të Kosovës të intervistuar për këtë studim deklaruan se dëgjojnë të shtëna me armë çdo ditë, ku afër 9 përqind të tjerë deklarojnë se dëgjojnë të shtëna disa herë në ditë. Kjo dallon shumë me shënimet për të gjithë Kosovën, ku numri më i madh i njerëzve (46 përqind) kanë deklaruar se dëgjojnë të shtëna nga armët disa herë në vit.

Si pasojë, nuk është e çuditshme që një shumicë e Serbëve të Kosovës të intervistuar për këtë studim besonin që armët ilegale paraqitnin kërcënim për prosperitetin e Kosovës, ku 95.5 përqind të tyre raportuan këtë mendim. Të njëjtin gjithashtu e kishin edhe shumica e të gjithë të intervistuarve prej 85 përqind (82.8 përqind e Shqiptarëve të Kosovës e ndanin këtë mendim).

Iniciativat për mbledhjen e armëve

Shumica e të intervistuarve perceptonin ‘frikën nga konflikti/jostabiliteti’ si arsyen kryesore pse njerëzit nuk i dorëzojnë armët e tyre gjatë amnestive të armëve (28.4 përqind). 25.5 përqind të tjerë perceptuan ‘traditën’ si arsyen kryesore, dhe 13.2 përqind konsideruan ‘mosbesimin në garantuesit e sigurisë’ si arsyen kryesore. Një proporcion i lartë i të intervistuarve që i takojnë kategorisë së moshës më të vjetër (55+) perceptuan ‘frikën nga konflikti/jostabiliteti’ si arsyen kryesore pse njerëzit nuk i dorëzojnë armët e tyre gjatë amnestive (31.1 përqind), që dallon prej kategorisë së moshës më të re prej 18-24 vjet (17.6 përqind).

Një proporcion më i lartë i Serbëve të Kosovës perceptuan ‘frikën nga konflikti/jostabiliteti’ (43.1 përqind) dhe ‘mosbesimin në garantuesit e sigurisë’ (29.1 përqind) si arsyt kryesore pse njerëzit nuk i dorëzojnë armët e tyre gjatë amnestive, që dallon nga mendimet e raportuara të intervistuarve Shqiptarë të Kosovës (respektivisht 25.7 përqind dhe 9.8 përqind). Për dallim, më shumë Shqiptarë të Kosovës perceptuan ‘traditën’ si arsyen kryesore (30.7 përqind), ndërsa 5.4 përqind e të intervistuarve Serbë të Kosovës identifikuan të njëjtën si arsye. Kjo nuk është për tu befasuar duke ditur që Serbët e Kosovës u besojnë shumë pak garantuesëve të sigurisë dhe shprehin frikë më të madhe për një konflikt të ardhshëm se sa Shqiptarët e Kosovës (shih më lartë gjetjet nga fokus grupet).

Fokus grup diskutimet theksuan që Shqiptarët e Kosovës besonin më shumë që statusi i pazgjidhur i Kosovës ishte arsyeja kryesore pse njerëzit nuk i kishin dorëzuar armët e tyre gjatë amnestive, që dallon prej Serbëve të Kosovës të cilët perceptonin mosbesimin tek garantuesit e sigurisë si arsyen kryesore. Për shembull, një mashkull 28 vjeçar, pjesëmarrës në fokus grupin e mbajtur në Prizren, deklaroi që “askush nuk do të dorëzoj armët e tyre derisa të definohet statusi përfundimtar”.

Shumica e të intervistuarve (25.1 përqind) mendonin se mënyra më e mirë për t’i nxitur njerëzit në komunitetet e tyre që t’i dorëzojnë armët do të ishte “nëse do të ishte shpallur një amnisti në tërë Kosovën (pa dënime)”; 12 përqind mendonin që “mbajtja e një amnestie në nivelin e komunitetit” do të ishte nxitja më e mirë. Të gjitha fokus grupet theksuan që nxitjet ekonomike individuale dhe/ose të komunitetit do të ishin mënyrat më të mira për të nxitur njerëzit që t’i dorëzojnë armët e tyre ilegale. Fokus grupi theksoi që Serbët e Kosovës besonin se njerëzit më shumë do t’i dorëzonin armët e tyre nëpërmes amnestive të organizuara nga institucionet të cilave ata u besojnë, siç deklaroi një mashkull 30 vjeçar: “OJQ-të të cilat kanë fituar besimin e njerëzve do të ishin më të përshtatshmet për drejtimin e këtij aktiviteti”. Shqiptarët e Kosovës dhe Serbët e Kosovës dallonin në pikën se çfarë do të nxiste njerëzit më shumë që të dorëzonin armët e tyre, siç edhe mund të shihet më poshtë në Figurën 18.




Figura 18: Sipas mendimit tuaj, cilat nga veprimet në vazhdim do të nxitnin më së miri njerëzit në komunitetin tuaj që të dorëzonin armët e tyre ilegale?
Numri bazë: 1,120

Përfundim

Ky studim është i pari nga disa që kanë për qëllim përcjelljen e trendëve të sigurisë dhe konfliktit për ofrimin e informacione të detajizuara për të ndihmuar në politikë-bërje të përgjegjshme. Gjetjet e paraqitura këtu ilustronë disa grupe të rëndësishme të perceptimeve mbi sigurinë të perceptuara nga njerëzit.

Krimi, përfshirë edhe krimin e armatosur, perceptohet si i zakonshëm nga shumë të intervistuar, por ekzistojnë disa komuna ku njerëzit raportojnë frikë minimale nga krimi. Hulumtime tjera janë të nevojshme për të gjetur arsyet pse krimi nuk është fare shqetësim në disa komuna e në disa tjera frika nga krimi është e madhe. Të intervistuarit Serbë të Kosovës duken të jenë më të frikësuar se mund të bëhen viktimë e krimit në krahasim me komunitetet tjera. Derisa kjo mund të vije si pasojë e niveleve të larta të krimit, e njëjta gjithashtu mund të vije si pasojë e perceptimit më të madh të cenueshmërisë dhe pasigurisë brenda komuniteteve, që edhe mund të keqësoj frikën nga krimi.

Është e qartë se ka nevojë për më shumë punë nga garantuesit e sigurisë dhe institucionet në Kosovë (ndërkombëtare dhe lokale) për përmirësimin e kuptimit publik të kompetencave institucionale dhe krijimin e besimit në mesin e popullatës. Shërbimi Policor i Kosovës duket të ketë bërë progres të rëndësishëm këtu. Sidoqoftë, ky studim gjithashtu tregon që shumë njerëz mendojnë se shërbimi policor është i hapur ndaj ndikimit nga vepruesit e jashtë (si partitë politike dhe anëtarët e komunitetit). Garantuesit ndërkombëtar të sigurisë, sidomos Policia e UNMIK-ut, nuk gëzojnë nivele të larta të besimit nga publiku, të cilët gjithashtu i konsiderojnë si të paaftë. Kampanjat e qasjes nga organizata ndërkombëtare nuk duket të kenë arritur tek publiku i gjerë. Strukturat institucionale si KLSP-të dhe KSK-të, të cilat do të paraqitnin një mundësi të mirë për plotësimin e hapësirave në mes komuniteteve lokale dhe politikëbërjen e sigurisë në nivelin qendror, deri më tani kanë dështuar të ngritin informimin në mesin e zonave të tyre elektorale.

Ndonëse ky studim nuk kishte për qëllim vlerësimin e numrit total të armëve në Kosovë, ai vështrori perceptimet se sa shpesh armët janë parë ose sa shpesh të shtënat janë dëgjuar në një lagje dhe mbi frekuencën e incidenteve përfshirë lëndimet nga armët e zjarrit si masa të sigurisë në komunitet. Ndoshta më e habitshme është numri i incidenteve të raportuara të lidhura me armë zjarri të cilat kanë ndodhur gjatë gjashtë muajve deri në dhjetor 2006. Sidoqoftë, ishin dy herë më shumë të intervistuar të cilët mendonin se posedimi i një arme zjarri nuk do t'i bënte ata më sigurt në krahasim me ata që mendonin se do t'i bënte të ndjeheshin më të sigurt, duke paraqitur kështu një informacion të dobishëm për iniciativat e ardhshme të mbledhjes së armëve.

Gjetjet për sigurinë në komunitet tregojnë se pasiguria nuk është shqetësuese në jetën e përditshme të njerëzve. Sigurisht, frika nga krimi dhe besimi në garantuesit e sigurisë janë të lidhura ngushtë me perceptimet mbi sigurinë. Por edhe faktorët socio-ekonomik gjithashtu luajnë një rol të madh në përcaktimin se sa të sigurt ndjehen njerëzit, dhe në afat më të gjatë, sidomos pasi të vendoset mbi statusin e ardhshëm të Kosovës, krijimet e vendeve të punës dhe ulja e varfërisë do të jenë kyçe në promovimin e stabilitetit dhe sigurisë në të ardhmen.

Aneksi A: Margjina e gabimit

Diferenca e gabimit është radiusi (gjysma) i intervalit të besimit 99%, ose 1.96 gabime standarde, kur $p = 50\%$. Si e tillë, mund të kalkulohet direkt nga numri i të intervistuarve.

$$\text{Diferenca e gabimit (95\%)} = 1.96 \times \frac{0.5(1 - 0.5)}{\sqrt{n}}$$

Studimi siguria njerëzore në Kosovë pati 1,153 të intervistuar. Në intervalin e besimit 95% kjo do të thotë 2.89% gabime standarde në total.³³

Diferenca e gabimit (95%) = 0.0289 = 2.89% (në kuptimin që është e sigurt që proporcioni real në popullsi është diku në mes 47.11% dhe 52.89%).

Si përfundim, diferenca e gabimit është 95% e intervalit të besimit për përqindjen e raportuar prej 50% dhe nëse p largohet nga 50% atëherë intervali i besimit rreth p do të jetë më i vogël. Si rrjedhojë, diferenca e gabimit paraqet një lidhje të lartë me pasigurinë; është e sigurt së paku 95% që përqindja “e vërtetë” është brenda diferencës së gabimit të përqindjes së raportuar për çfarëdo përqindje të raportuar.

³³ Nuk ekzistojnë shifra të sakta mbi popullsinë e Kosovës. Për kalkulimin e diferencës së gabimit këtu, popullsia u konsiderua të jetë 2.1 milion. Vlerësimet sillen prej 1.8 milion deri 2.4 milion. Për shqyrtimin e vlerësimeve të ndryshme mbi popullsinë e Kosovës, shih *Statistikat Vitale të Kosovës 2002-2003* (Zyra Statistikore e Kosovës, nëntor 2004), p 7, që mund të gjendet në: http://www.ks-gov.net/esk/esk/pdf/english/population/stat_vital_02_03.pdf; *Kosova dhe Popullsia e saj* (Zyra Statistikore e Kosovës, shtator 2003) p6, që mund të gjendet në: http://www.ks-gov.net/esk/esk/pdf/english/population/Kosovo_population.pdf; dhe *Situata Demografike, Sociale dhe Riprodhuese në Kosovës: Hulumtim Shtëpiak* (Fondi Popullor i Kombeve të Bashkuara, korrik 2003), që mund të gjendet në: <http://www.unfpa.org/docs/DHS-2003/English.pdf>